

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 337, Datë 18.12.2025

MBI

**VLERËSIMIN E RAPORTIT VJETOR TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST) SH.A. PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 16, 54 dhe 58, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 103, datë 30.04.2018, “Mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a.”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator, me nr. 3089 prot., datë 17.12.2025, “Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OST” sh. a., për vitin 2024”,

Konstatoi se:

1. Parashtrimi dhe shqyrtimi i Raportit Vjetor të Pajtueshmërisë për vitin 2024

- Në zbatim të neneve 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, i ndryshuar, dhe të Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a., Zyrtari i Pajtueshmërisë ka detyrimin të raportojë periodikisht dhe çdo vit pranë ERE mbi monitorimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë, me qëllim garantimin e ndarjes funksionale, organizative dhe vendimmarrëse, mbrojtjen e informacionit konfidencial dhe zbatimin e parimit të mosdiskriminimit.
- ERE, në ushtrim të funksionit mbikëqyrës, vlerëson raportin vjetor të pajtueshmërisë dhe përcakton rekomandime për përmirësimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

2. Dorëzimi dhe shqyrtimi i raportit për vitin 2024

- Në zbatim të vendimit të bordit të ERE-s nr. 252, datë 25.11.2024, (pika 2), deri në përfundimin e procesit të miratimit të kontratës dhe emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga ERE, detyrat dhe funksionet përkatëse janë kryer nga Zyrtari aktual i Pajtueshmërisë, i miratuar me vendimin nr. 50/2021 të Bordit të ERE-s.
- Zyrtari i Pajtueshmërisë i OST sh.a. ka depozituar pranë ERE Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë së OST sh.a. për vitin 2024, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1140/3 prot.
- Nga shqyrtimi i materialit rezulton se raportimi i Zyrtarit ka si periudhë monitorimi vitin kalendarik janar–dhjetor 2024, ndërkohë që në hyrje është reflektuar periudha “31 mars – 31 dhjetor 2024”, e cila vlerësohet si lapsus material.

3. Përbushja e detyrimeve nga Zyrtari i Pajtueshmërisë për vitin 2024

- Nga analiza e raportit dhe verifikimet e kryera nga ERE, rezulton se OST sh.a. ka ruajtur ndarjen dhe pavarësinë institucionale, financiare dhe operacionale dhe nuk janë evidentuar shkelje të Programit të Pajtueshmërisë për vitin 2024.
- Është konstatuar përbushja e detyrimeve të lidhura me pavarësinë e audituesit financiar dhe transparencën e njoftimit për përzgjedhjen e audituesve, në funksion të kushteve të certifikimit të OST sh.a. si operator i pavarur.
- Në aspektin e sigurisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike, raportimi pasqyron masa të qëndrueshme kontrolli dhe mbrojtjeje, si dhe përputhshmëri me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

4. Nevoja për përmirësim dhe rekomandime për periudhën pasardhëse

- Nga vlerësimi i raportit vjetor të pajtueshmërisë për vitin 2024, rezulton se disa elemente kërkojnë përmirësim dhe raportim të plotësuar, konkretisht:
 - a) Raportim më i qartë dhe i përditësuar mbi strukturën organizative të OST sh.a. dhe ndryshimet eventuale, në përputhje me detyrimet raportuese të Programit të Pajtueshmërisë, si dhe rekomandimi që ky raportim të kryhet brenda dy muajve të parë të vitit pasardhës.
 - b) Përbushja e plotë e detyrimeve të Programit lidhur me të dhënat dhe platformat e informacionit, përfshirë rishikimin dhe përditësimin të paktën një herë në vit të listës së autorizimeve për aksesin në informacionin tregtar të ndjeshëm.
 - c) Përbushja e detyrimeve të Programit për informacionin publik, përfshirë raportimi mbi arkivimin e informacionit konfidencial.
 - d) Depozitimi pranë ERE i informacionit të detajuar mbi përdorimin e të ardhurave nga rrjeti OPGW, duke përfshirë analizën e kryer nga Drejtoria Teknike dhe vlerësimin e pavarur të Zyrtarit të Pajtueshmërisë mbi ndikimin në pavarësinë financiare të OST sh.a., në përputhje me kërkesat e Programit dhe Vendimin nr. 194/2019.
 - e) Forcimi i mekanizmave të dokumentimit dhe gjurmueshmërisë për shkeljet e Programit, trajnimin/udhëzimin e stafit dhe konsultimet e dhëna, me qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së plotë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin pjesërisht të Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë “OST” sh.a., për vitin 2024 të hartuar nga Zyrtari. (Bashkëlidhur)
2. Miratimin e Vlerësimeve dhe Rekomandimeve të ERE-s për vitin 2024, mbi Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. (Bashkëlidhur)
3. Zyrtari duhet të raportojë periodikisht çdo muaj të vitit pasardhës për plotësimin e rekomandimeve të lëna në këtë raportim.

4. Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a., Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe Sekretariatit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI



RAPORTI I PAJTUESHMËRISË PËR VITIN 2024

Mbi masat e ndërmarra për implementimin e Programit të Pajtueshmërisë për periudhën 01 Janar – 31 Dhjetor 2024 në shoqërinë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a.

Tiranë, Prill 2025

Brunilda Veizi
zyrtariipajtueshmerise@ost.al

Tabela e përmbajtjes

| | |
|--|-----------|
| KAPITULLI I | 3 |
| 1. Hyrje | 3 |
| 2. Shoqëria | 4 |
| 3. Programi i pajtueshmërisë – Metodologjia e kontrollit | 4 |
| 4. Parimet kryesore që drejtojnë veprimtarinë e OST | 5 |
| 4.1 Trajtimi i barabartë i përdoruesve të rrjetit | 7 |
| 4.1.1 Sistemet e informacionit të OST..... | 7 |
| 4.1.2 Investimet ne rrjetin e transmetimit..... | 11 |
| 4.1.2.1 Përdorimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i rrjetit të fibrave optike (OPGW) si pjesë e rrjetit të transmetimit, për qëllime komerciale..... | 14 |
| 4.1.3 Aksesit i Palëve të Treta në sistemin e transmetimit..... | 17 |
| 4.1.4 Pajtueshmeria e përdoruesve të rrjetit me Kodin e Transmetimit..... | 18 |
| 4.1.5 Tregu Balancues i Energjisë Elektrike..... | 21 |
| 4.1.5.1 Pjesëmarrësit e tregut të energjisë..... | 21 |
| 4.1.5.2 Prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve ne rrjetin e transmetimit..... | 23 |
| 4.1.5.3 Ankandet mbi alokimin e kapaciteteve..... | 24 |
| 4.1.5.4 Palët përgjegjëse për balancim..... | 25 |
| 4.2 Konfidencialiteti i të dhënave dhe i informacionit të ndjeshëm tregtar | 27 |
| 4.2.1 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit..... | 27 |
| 4.2.2 Siguria e sistemeve të informacionit..... | 32 |
| 4.2.3 Të dhënat e platformave..... | 36 |
| 4.2.3.1 Të dhënat që hidhen nga përdoruesit e sistemeve..... | 36 |
| 4.2.3.2 Informacioni që palët e treta marrin nëpërmjet platformave..... | 37 |
| 4.3 Pavarësia e shoqërisë | 38 |
| 4.3.1 Çertifikimi i OST si operator i pavarur i transmetimit..... | 38 |
| 4.3.2 Pavarësia e Menaxhimit..... | 40 |
| 4.3.2.1 Këshilli Mbikqyrës..... | 41 |
| 4.3.2.2 Administratori..... | 42 |
| 4.3.2.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës..... | 42 |
| 4.3.2.4 Drejtuesit e OST..... | 42 |
| 4.3.3 Pavarësia financiare..... | 44 |
| 4.3.3.1 Programi ekonomik..... | 44 |
| 4.3.3.3 Audituesit ligjorë..... | 45 |

| | |
|--|-----------|
| 4.3.4 Pavarësia operationale | 46 |
| KAPITULLI II | 46 |
| 5. Zbatimi i rekomandimeve të zyrta të pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të programit të pajtueshmërisë | 46 |
| 5.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës | 46 |
| 5.2 Trajnimet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/sekretit tregtar | 47 |
| 5.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron | 47 |
| 5.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë..... | 48 |
| 6. Rekomandimet e zyrta të pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të programit të pajtueshmërisë | 48 |
| 6.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës | 48 |
| 6.2 Trajnimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar | 48 |
| 6.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron | 48 |
| 6.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë..... | 49 |
| KAPITULLI III..... | 49 |
| 7. Konkluzione..... | 49 |

KAPITULLI I

1. Hyrje

Ky raport hartohet në bazë të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC”, Vendimit të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, nr.43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a” si dhe Programit të Pajtueshmërisë për OST sh.a.

Ky raport është përgatitur nga zj. Brunilda Veizi (këtu e më poshtë referuar si Zyrtari i Pajtueshmërisë).

Zyrtar i Pajtueshmërisë është caktuar me vendim nr.20 datë 30.05.2017 të Këshillit Mbikqyrës të OST, i cili është miratuar më pas me vendim të Bordit të ERE-s, nr. 147, datë 28.09.2017.

Me Vendim nr. 21, date 28.11.2020, Këshilli Mbikqyrës i OST ka riemëruar Zyrtarin e Pajtueshmërisë si dhe Kontratën e ofrimit të shërbimeve të ZP, miratuar me Vendim nr. 50, datë 17.02.2021 të Bordit të ERE-s, vendime të bazë të cilave është lidhur kontrata “Për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë” ndërmjet ZP dhe OST, me afat deri në datë 4 Mars 2024.

Me vendim nr. 252, datë 25.11.2024, ERE ka vendosur fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë dhe miratimin e emërimit të Zyrtarit të pajtueshmërisë të propozuar nga OST, ku ndër të tjera ka vendosur: “.....Deri në përfundim të procesit të miratimit të Kontratës dhe emërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë nga ERE, detyrat dhe funksionet përkatëse do të vazhdojnë të kryhen nga Zyrtari aktual, i miratuar nga ERE me vendimin nr. 50/2021.”

Në bazë të Vendimit të lartpërmendur, në datë 12.12.2024, është nënshkruar kontrata për ofrimin e shërbimeve ndërmjet ZP dhe OST.

Ky raport vjetor hartohet në bazë të detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, në lidhje me Programin e Pajtueshmërisë, i miratuar me vendim të Bordit të ERE-s, nr.103, datë 30.04.2018 “Për miratimin e programit të pajtueshmërisë të OST sh.a.

Në bazë të pikës C.62 të Programit të Pajtueshmërisë, çdo vit jo më vonë se data 31 Mars, Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të përgatisë dhe dorëzojë në ERE një raport për përputhshmërinë e OST me këtë Program.

Me anë të shkresës nr. 1130/2 prot., datë 12.03.2025, nga ana e Zyrtarit të Pajtueshmërisë, është kërkuar shtyrja e afatit të dorëzimit të Raportit për vitin 2024, për shkaqe të arsyeshme, e cila është miratuar nga ERE me anë të shkresës nr. 1140/2 prot., datë 01.04.2025.

Raporti i përgatitur për vitin 2024 përshkruan masat e ndërmarra për implementimin e Programit të Pajtueshmërisë për periudhën 31 Mars – 31 Dhjetor 2024, me qëllim sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të OST ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të energjisë elektrike dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisë e OST, konfidencialitetit të të gjithë informacionit të menaxhuar nga OST si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj.

Informacioni i nevojshëm në përgatitjen e këtij Raporti, ashtu si çdo vit, është siguruar nga strukturat përkatëse të OST sipas funksioneve që ata kryejnë, siç janë Drejtoria e Drejtimit Operativ të Sistemit, Drejtoria e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Planifikim Zhvillim të Rrjetit të Transmetimit, Departamenti i Operimit të Sistemit, Drejtoria e Shërbimeve të Tregut, Drejtoria e Operimit të Tregut, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Çështjeve Korporative, Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Projekteve të Huaja.

2. Shoqëria

Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST sh.a. është krijuar dhe funksionon në formën e shoqërisë aksionare në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, regjistruar si person juridik me Vendimin nr.31935, datë 17.4.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OST sh.a. është e organizuar në formën e shoqërisë aksionare me kapital 100% shtetëror me aksionar të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 3, datë 17.01.2024 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit”, si përfaqësuese të Shtetit si pronar të aksioneve të OST sh.a.

Në bazë të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, OST është personi juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

3. Programi i pajtuëshmërisë – Metodologjia e kontrollit

OST si shoqëri ka miratuar dhe implementon një Program Pajtuëshmërie, duke përcaktuar masat që duhen ndërmarrë, për të siguruar pavarësinë e saj, të parandalojë çdo formë trajtimi diskriminues dhe të aplikojë procedurat e duhura për të monitoruar pajtuëshmërinë e Stafit Drejtues dhe punonjësve të shoqërisë, me Programin e Pajtuëshmërisë.

Më specifikisht, Programi i Pajtuëshmërisë përcakton çështjet kyçe që duhen monitoruar në lidhje me:

- Shmangien e sjelljeve diskriminuese në aktivitetet e OST;
- Pavarësinë e OST.

Monitorimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve është kryer duke aplikuar metodologjinë si më poshtë:

- Mbledhje informacioni dhe dokumentacioni nga strukturat përkatëse të shoqërisë;
- Intervista me stafin përgjegjës të përfshirë në këto struktura;
- Hulumtim i dokumentacionit të vënë në dispozicion (të tilla si vendime, kontrata, rregullore, relacione etj).

Shqyrtimi, trajtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit dhe informacionit të vënë në dispozicion janë trajtuar nga Zyrtari i Pajtuëshmërisë në respektim të detyrimeve të marra përsipër me anë të kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë si dhe bazuar në:

- Sjelljen etike (besim, integritet, profesionalizëm dhe diskrecion);
- Në një prezantim të drejtë: detyrimi për të raportuar në mënyrë të kujdesshme, me vërtetësi dhe paanshmëri, si dhe
- Kujdesin e duhur profesional.

Monitorimi është kryer në ambjentet e OST dhe ka konsistuar në:

- Komunikim nëpërmjet e-mailit për mbledhjen e informacionit të nevojshëm;
- Intervista;
- Shqyrtim dokumentacioni.

Shtyllat kryesore që sigurojnë parimet themelore të veprimtarisë së OST dhe që janë konsideruar si pika kyçe të këtij Raporti, janë si më poshtë:

- Pavarësia e OST nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- Konfidencialiteti i të dhënave dhe i informacionit të ndjeshëm tregtar: Përcaktimi, klasifikimi dhe ruajtja e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar, përfshirë atë që i përket përdoruesve të sistemit si dhe ato që i përkasin aktivitetëve të OST;
- Trajtim i barabartë i përdoruesve të sistemit: Detyrimi i OST që të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë përdoruesit e sistemit dhe shmangien e praktikave diskriminuese dhe të njëanshme si dhe të çdo praktike që shtrembëron konkurrencën.

4. Parimet kryesore që drejtojnë veprimtarinë e OST

OST është tashmë anëtare e ENTSO-E Rrjetit European i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike, krijimi i së cilës mbështetet në parashikimet e bëra në Paketën e Tretë Legjislative të BE-së për Tregun e Brendshëm të Energjisë e cila synon liberalizimin e mëtejshëm të tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit në Bashkimin European.

Për shkak të procesit të hapjes dhe liberalizimit të tregut të energjisë, OST-të kanë marrë një rol të rëndësishëm bashkëveprues dhe janë bërë një pikë takimi për të gjithë pjesëmarrësit në treg. Paketa e Tretë e Energjisë e cila përbëhet nga dy direktiva dhe tre Rregullore Evropiane dhe në veçanti Direktiva (EC) 714/2009 “Mbi kushtet e hyrjes në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike”, nga e cila e ka burimin, krijimi i ENTSO-E, përcakton përgjegjësitë e ENTSO-E në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet OST-ve në të gjithë BE-në për të ndihmuar në zhvillimin e një rrjeti të transmetimit të energjisë elektrike pan-european në përputhje me qëllimet e politikës energjitike të saj.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër si anëtare e ENTSO-E, OST është tashmë nënshkruese dhe palë në shumë kontrata të lidhura ndërmjet ENTSO-E nga njëra anë dhe OST-ve anëtare të Europës Kontinentale.

Për sa i përket Shqipërisë, kjo paketë është pjesë e *acquis communautaire* të Komunitetit të Energjisë në të cilin Shteti Shqiptar është palë si rezultat i nënshkrimit dhe ratifikimit të “Traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë të vendeve të Evropës Juglindore” miratuar

me ligjin Nr. 9501, datë 03.04.2006 “Për ratifikimin e traktatit të komunitetit të energjisë”, traktat në bazë të të cilit shtetet nënshkruese marrin përsipër implementimin e legjislationit kyç të energjisë elektrike në BE, brenda një afati kohor të përcaktuar.

Në kuadër të zbatimit të parashikimeve të Paketës së Tretë të Energjisë si dhe të kuadrit ligjor e rregullator të brendshëm, OST duhet të jetë plotësisht e pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, të zhvillojë veprimtarinë e saj në mënyrë të paanshme dhe transparente.

Këto kërkesa rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për OST. Për të realizuar pajtueshmërinë me këto kërkesa, është e detyrueshme që çdo strukturë e OST të kërkojë dhe të sigurojë pajtueshmërinë me këto kritere.

Një pjesë e akteve legjislative të lartpërmendura kanë pësuar ndryshime pas votimit të suksesshëm të Këshillit në datë 18 Janar si dhe të Parlamentit Europian në 26 Mars 2019, pjesë e paketes “Energji e Pastër për të gjithë europianet”. Në datë 14 Qershor 2019, aktet legjislative të “Paketës për Energji të Pastër (CEP), u botuan në fletoren zyrtare të Bashkimit Europian, e konkretisht:

- Direktiva e Energjisë (Direktiva 2019/944 e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 5 Qershor mbi rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë që amendon Direktivën 2012/27/EU);
- Rregullorja e Energjisë (Rregullore 2019/943 e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 5 Qershor 2019 mbi tregun e brendshëm të energjisë);
- Rregullorja e ACER (Rregullore 2019/942 e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 5 Qershor për krijimin e Agjencisë së Bashkimit Europian për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë);
- Rregullorja e Parandalimit të Riskut (Rregullore 2019/941 e Parlamentit Europian dhe Këshillit e datës 5 Qershor mbi parandalimin e riskut dhe që ndryshon Direktivën 2005/89/EC.

Ky kuadër i ri ligjor ka një impakt domethënës mbi OST-të dhe ENTSO-E e cila në fillim të vitit 2019 ka lançuar një projekt mbi impaktin e Paketës për Energji të Pastër tek vetë organizata dhe OST-të si dhe për vetë OST në një të ardhme jo shumë të largët.

Një zhvillim i mëtejshëm i rëndësishëm që luan një rol vendimtar në përafrimin e legjislationit të brendshëm të vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë me atë të Bashkimit Europian në kuadër të tregut të brendshëm të energjisë, është dhe Vendimi D/2022/03/MC-EnC i Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë i datës 15 Dhjetor 2022 “Mbi inkorporimin e Rregullores (BE) 2019/942, Rregullorja (BE) 2019/943, Rregullores (BE) 2015/1222, Rregullores (BE) 2016/1719, Rregullores (BE) 2017/2195, Rregullores BE 2017/2196, Rregullores BE 2017/1485 në Acquis të Komunitetit të Energjisë, që ndryshon Aneksin I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe mbi ndryshimet e Vendimeve të Këshillit Ministror Nr. 2021/13/MC-EnC dhe Nr. 2011/02/MC-EnC.

4.1 Trajtimi i barabartë i përdoruesve të rrjetit

Në pikën 38 të Programit të Pajtueshmërisë përcaktohet se në përputhje me kërkesat e transparencës së kompanisë OST, duhet të sigurohet që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e OST. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregëtar duhet të shpërndalet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në faqen e internetit të OST. Në lidhje me këtë detyrim, është bërë monitorimi i informacionit të publikuar në website-in e OST.

4.1.1 Sistemet e informacionit të OST

OST ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë përdoruesit, në informacionin që shoqëria është e detyruar të publikojë në faqen e saj zyrtare, në bazë të kuadrit rregullator që drejton veprimtarinë e saj.

Në bazë të:

- Rregullores së Parlamentit Europian dhe Këshillit nr.714/2009 “Mbi kushtet për akses në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë”;
- Rregullores së Komisionit nr.543/2013, datë 14 Qershor 2013 “Mbi paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë”;
- Memorandumit të mirëkuptimit në lidhje me vënien në dispozicion të të dhënave nga anëtarët e ENTSO_E për Platformën e Transparencës, nënshkruar ndërmjet OST-ve anëtare të ENTSO-E dhe ENTSO_E
- Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike” i ndryshuar, si dhe
- Vendimit të Bordit të ERE-se nr.118, datë 27.07.2017 “Rregullat për publikimin e të dhënave baze të tregut të energjisë elektrike,

OST ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar implementimin e duhur, nëpërmjet publikimit të informacionit publik në website-in zyrtar të saj, duke siguruar një përshkrim të shoqërisë, të veprimtarisë së saj, kuadrit ligjor rregullator si dhe të shërbimeve që ofron, me transparencë, paanshmeri dhe pa diskriminim, për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Në referim të pikës 42 të Programit të Pajtueshmërisë, informacioni që publikohet në website-in zyrtar të OST, konsiston në:

- Informacion të plotë mbi kuadrin ligjor dhe rregullator si dhe dokumentacion e nevojshëm udhëzues mbi aplikimin dhe dokumentat për aplikimin për lidhje të re/modifikimin të lidhjes ekzistuese në sistemin e transmetimit;
- Informacion mbi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike miratuar me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s;
- Informacion mbi alokimin e kapaciteteve të transmetimit, të dhëna për pjesëmarrësit e ankandeve, rregullat për alokimin e kapaciteteve;
- Informacion mbi kapacitetin e lirisë të përdorura;

- Informacion mbi procedurat e prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit si dhe rezultatet e këtyre procedurave, rregullat për mekanizmin balancues, lista e pjesëmarrësve të tregut balancues;
- Lista e pjesëmarrësve të regjistruar në tregun balancues të energjisë elektrike, formularët për regjistrimin e tyre, kontrata tip për shërbimin e transmetimit e miratuar nga ERE.

Nga monitorimi i herëpashershëm i website-it zyrtar të OST, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e ERE-s, vërehet se ai është riorganizuar duke përmirësuar mënyrën e dhënies dhe organizimit të informacionit të duhur sipas fushave të caktuara, duke bërë një prezantim më të mirë, menaxhimin e duhur të informacionit të rëndësishëm si dhe pajtueshmërinë me standardet e sigurisë që aplikohen për sistemet e informacionit, te tilla si:

- Zbatimi i Protokolleve të Sigurisë: Përdorimi HTTPS për të siguruar një lidhje të koduar mes serverit të website-it dhe përdoruesit, që mbron të dhënat e transmetuara.
- Përditësimet e Software-it: website mbahet i përditësuar për të shmangur ekspozimin ndaj dobësive të sigurisë.
- Auditimet e Sigurisë: Kryen në përgjithësi auditime të rregullta të sigurisë për të identifikuar dhe adresuar çdo çështje të mundshme të sigurisë që mund të ndikojë në integritetin e website-it.

OST kujdeset në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar që informacioni i publikuar të jetë gjithmonë i saktë, i sigurt dhe përmbush nevojat e kompanisë dhe përdoruesve. Përmbajtja e faqes është gjithmonë e përditësuar dhe reflekton ndryshimet më të fundit në politikat, procedurat dhe lajmet e shoqërisë. Në mënyrë të vazhdueshme kryhet verifikimi i saktësisë së informacionit të publikuar për të shmangur çdo keqinformim të mundshëm të përdoruesve ose palëve të interesuara.

Në respektim të akteve të lartpërmendura, OST publikon rregullisht në faqen online të saj, të dhënat si më poshtë:

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Departamenti i Operimit:

- Në rubrikën “Operimi” – “Të dhëna”, janë të publikuara: *Parashikimi D-1 i ngarkesës totale per BZ dhe Parashikimi W-1 i ngarkesës totale per BZ* (<https://ost.al/te-dhena/>), për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Gjithashtu, rezultojnë të publikuara të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve të Tregut, si vijon:

Sipas rregullave për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 118, datë 27.07.2017:

- Rregullat e balancimit: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/legjislacioni/>;
- Sasia e rezervës balancuese sipas kontrates: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energji-balancuese/kapaciteti-rezerve/>;
- Çmimet e kapacitetit rezervë të rezervave balancuese: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energji-balancuese/kapaciteti-rezerve/>;

- Sasia e ofertave të pranuar: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energji-balancuese/kapaciteti-rezerve/>;
- Sasia e rezervave të balancimit të aktivizuara: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energji-balancuese/energji-balancuese/>;
- mimi i rezervave të balancimit të aktivizuara: <https://ost.al/balancimi/tregu-shqiptar-i-balancimit/kapaciteti-rezerve-dhe-energji-balancuese/energji-balancuese/>;
- Çmimet e disbalancave: <https://ost.al/balancimi/disbalancat/>;
- Sasia totale e disbalancave: <https://ost.al/balancimi/disbalancat/>.

Sa i përket të dhënave që publikohen në bazë të Rregullores së Komisionit Europian nr.543/2013, datë 14 Qershor 2013 dhe Memorandumit të Mirëkuptimit në lidhje me vënien në dispozicion të të dhënave nga anëtarët e ENTSO_E për Platformën e Transparencës, OST momentalisht ka arritur të publikojë mesatarisht rreth 77.2% të të dhënave të konfiguruar në platformën e Transparencës, kjo referuar raporteve që përcillen nga ENTSO-E. Një pjesë e konsiderueshme të dhënash referuar tregut balancues, shërbimeve ndihmëse (rezervave, kapacitetit, çmimet) vazhdojnë të publikohen manualisht në platformën TP si të dhëna historike pasi, në vitin 2024 OST është njohur me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 148, datë 25.07.2024, “Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minutësh në operimin e proceseve në tregun e balancimit deri më 11.06.2025”, që solli ndryshim në konfigurime për sa i përket rezolucionit të këtyre të dhënave. Si rrjedhojë ofruesi i shërbimit po konfiguronte platformën që këto të dhëna të publikohen automatikisht dhe në kohë reale, gjë që do të rrisë akoma më shumë përqindjen e të dhënave të publikuara në kohë reale nga ana e OST në Platformën e Transparencës (TP) të ENTSO-E.”

4.1.2 Zhvillimi i sistemit të transmetimit

Nga ana e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë i është kërkuar strukturave përkatëse (Drejtoria e Planifikimit Zhvillim të Rrjetit të Transmetimit, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria Ekonomike), për të siguruar informacionin e duhur mbi implementimin e projekteve sipas planit 10 vjeçar të zhvillimit të shoqërisë.

Aktualisht, në zbatim mbetet ende Programi 10 vjeçar i Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit për periudhën 2015-2025 i miratuar nga ERE me Vendim Nr.186, datë 10.11.2017.

Përditësimi i Planit 10-vjeçar 2015-2025 konsiston në vitin e komisionimit për objektet të cilat janë në proces apo parashikohen të përfshihen në investime nga dokumenti i miratuar nga ERE. Nga lista e vetmi tregues i ndryshuar është viti i komisionimit për ato objekte të cilat janë në proces apo parashikohen të përfshihen në investime. Kjo edhe si pasojë e faktorëve të ndryshëm ku mund të listohen të tillë si procedurat e prokurimit, shpronësimet etj.

Në tabelën e mëposhtme jepet lista e përditësuar e këtij plani e cila përmban të ndryshuar vitin e komisionimit për ato projekte të cilat janë në proces apo përfshihen në investime.

Tabela më poshtë pasqyron planin e paraqitur në ERE:

Plani dhjetëvjeçar 2015 - 2025 i zhvillimit të rrjetit të transmetimit¹

¹ Informacion i marrë nga Drejtoria e Planifikimit Zhvillim të Rrjetit të Transmetimit

Raporti i Pajtuëshmërisë për vitin 2024

| | Objektet | Tipi i Përcjellësit (mm ²) | Gjatesia (km) | Fuqia (MVA) | Viti i Komisionimit | Vlera (Euro) |
|----|---|--|---------------|-------------|---------------------|-------------------|
| 1 | Linja 110 kV Uznove - Corovode dhe dalja 110 kV Uznove | ACSR 240/40 | 33 | 122 | 2015 | 3,320,000 |
| 2 | Linja 110 kV Lapaj - Peshkopi dhe dy dalje 110 kV | ACSR 240/40 | 32 | 122 | 2015 | 3,500,000 |
| 3 | Blerja e dy AT 220/110/10 kV Burrel | 2x 60 MVA | - | 120 | 2015 | 1,600,000 |
| 4 | Blerja e nje AT 220/110/35 kV Elbasan | 1x120 MVA | - | 120 | 2015 | 1,200,000 |
| | Blerja e nje AT 220/110/35 kV Elbasan | 1x120 MVA | - | 120 | 2017 | 1,200,000 |
| 5 | Linja 110 kV me dy qarqe Burrel- Bulqize dhe dy dalje linje 110 kV | 2xACSR 240/40 | 30 | 122 | 2022 | 4,000,000 |
| 6 | Linje e re 110 kV, Rrashbull-Golem-Kavaje | 2xACSR 240/40 | 18 | - | 2016 | 1,700,000 |
| 7 | Linja me dy qarqe Ulez- Shkopet - Skuraj; | 2xACSR 240/40 | 10.5 | | 2016 | 1,800,000 |
| 8 | Linja me nje qark Skuraj - Lac-1 | ACSR 240/40 | 12.7 | | 2019 | 1,800,000 |
| 9 | Linja me nje qark Skuraj -Lac-2 | ACSR 240/40 | 10.1 | | | |
| 10 | Linja me dy qarqe Lac2-Lac1 | 2xACSR 240/40 | 2.7 | | | |
| 11 | Perforcim Linje 110 kV, Lezhe-Laçi2 | ACSR 240/40 | 19.5 | - | 2023 | 1,700,000 |
| 12 | Perforcim Linje 110 kV, Ulez-Kurbnesh | ACSR 240/40 | 23.0 | - | 2025 | 2,000,000 |
| 13 | Linje e re 110 kV, Lapaj-Lure, 2 Dalje linje 110 kV | ACSR 240/40 | 19.0 | - | 2023 | 1,600,000 |
| 14 | Linje e re 110 kV, Sukth-Gj.Lalzit, 2 Dalje linje 110 kV | ACSR 240/40 | 18.0 | - | 2020 | 1,900,000 |
| 15 | Linje e re 110 kV, Bulqize-Termove-Gjorice | ACSR 240/40 | 20.0 | | 2025 | 1,900,000 |
| 16 | 220/110 kV Fierze, 1 Dalje Transformatori 220 kV, 1 Dalje Transformatori 110 kV | - | - | 2 x 60 | 2020 | 2,000,000 |
| 17 | Linje e re 110 kV, Kukës-Prizren, 1 Dalje linje 110 kV, Nst. Kukës | ACSR 240/40 | 13.0 | - | 2025 | 1,500,000 |
| 18 | Perforcim Linje 110 kV, Elbasan1-Fiber, Fiber-Librazhd | 2 x ACSR 240/40 | 30.0 | - | 2025 | 3,000,000 |
| 19 | Perforcim Linje 110 kV, Elbasan1-GSA-Cerrik-Kajan | ACSR 240/40 | 24.0 | - | 2023 | 2,040,000 |
| 20 | Perforcim Linje 110 kV, Kajan-Kucove-Marinez-Fier | ACSR 240/40 | 59.0 | - | 2023 | 5,015,000 |
| 21 | Linje e re 110 kV, Fier-Lushnje | ACSR 240/40 | 30.0 | - | 2024 | 2,400,000 |
| 22 | Plotesim i qarkut te dyte te linjes 220 kV Fier-Babice-TEC Vlore | ACSR 490/65 | 35.0 | - | 2025 | 1,000,000 |
| 23 | Linje e re 110 kV, Ballsh-Memaliaj | ACSR 240/40 | 48.0 | - | 2025 | 7,080,000 |
| 24 | Plotesimi i qarkut te dyte te linjes 110 kV, Kuçove-Uznove-Çorovode | ACSR 240/40 | 58.0 | - | 2025 | 1,000,000 |
| 25 | Linje e re 110 kV, Tirana1-Qender(Kabllore), 1 Dalje linje 110 kV. | XPLE-AL1000 | 2.3 | | 2025 | 1,500,000 |
| 26 | Linje e re 110 kV, Koplik-Shkodra1 | ACSR 240/40 | 20 | - | 2025 | 1,700,000 |
| 27 | Linje e re 110 kV, Kosmac-Velipoje | ACSR 240/40 | 28 | - | 2025 | 2,380,000 |
| | | | | | TOTALI | 59,835,000 |

Rreth 82% e projekteve të paraqitura më sipër pritet të përfundojnë brenda vitit 2024. Pjesa tjetër e mbetur pritet të realizohen brenda vitit 2025. Realizimi në masë të madhe i këtij programi 10 vjeçar të investimeve, përveç aspekteve të tjera ka sjellë nevojën e kryerjes së studimit të Master Planit të Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit 2018÷2033 dhe hartimin e Programit të Ri të Zhvillimit 2026÷2036.

Sa i përket “Programit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit 2026-2036” si dhe ecurisë së tij gjatë vitit 2024:

Me anë të shkresës nr.4948 Prot., datë 09.08.2022, OST ka dërguar në ERE për shqyrtim raportin përmbledhës të Programit të ri dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 2026÷2036. Pjesa e mbetur e investimeve do të përfshihen në planin e ri dhjetëvjeçar si vazhdim i planit aktual 2015÷2025 dhe të objektivave/strategjive të reja në sektorin e

energjisë elektrike duke reflektuar përgjigjen ndaj sfidave të reja për zhvillimin e qëndrueshëm dhe optimal të rrjetit të transmetimit në vend.

Në këtë kuadër, në datën 21.02.2023 në ERE është realizuar një seancë dëgjimore me përfaqësues të OST sh.a për paraqitjen e vlerësimeve mbi këtë plan.

Me anë të shkresës nr.502/4 Prot., datë 16.03.2023 ERE ka paraqitur disa rekomandime që duhen plotësuar nga OST, ku përmendim (i) saktësimi i periudhës së parashikuar të komisionimit të investimeve për periudhën 10 vjeçare 01.01.2026÷01.01.2036 dhe (ii) evidentimi se cilat investime të përfshira në planin aktual 10 vjeçar 2015÷2025, do të përfshihen në planin e ri 2026÷2036 duke dhënë dhe argumentet përkatëse.

4.1.2 Investimet në rrjetin e transmetimit

Investimet në rrjetin e transmetimit ndahen në 2 grupe kryesore:

1. Investime me financime nga institucione financiare ndërkombëtare;
2. Investime me fondet e OST.

1. Sa i përket investimeve me financime nga institucionet financiare ndërkombëtare:

Nuk ka projekte të reja të filluara në vitin 2024.

Sa i përket ecurisë së projekteve në proces implementimi, statusi i tyre rezulton si vijon:²

✚ Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni e Veriut) dhe Elbasan2 – Fier si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier:

- Kontrata e Lotit 1 është lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe Kontraktorit “JV Mitas Energy and Metal Construction Inc-DOKO sh.p.k” (Turqi & Shqipëri):

Ecuria gjatë vitit 2024:

Kontraktori fillimisht ka kryer punimet në segmentin e linjës ajrore Fier-Elbasan, duke kryer punimet civile që lidhen me rrugët hyrëse dhe punime të tjera për ndërtimin e themeleve të shtyllave. Punimet e ngritjes së shtyllave janë realizuar në masën 89 % të shtyllave të planifikuara për këtë segment.

Gjithashtu, vazhdojnë punimet për segmentin e linjës ajrore Elbasan – Qafë Thanë sa i takon punimeve civile që lidhen me rrugët hyrëse dhe punime të tjera për ndërtimin e themeleve të shtyllave. Ndërsa punimet e ngritjes së shtyllave janë në masën 53 % të shtyllave të planifikuara për këtë segment.

- Kontrata e Lotit 2 është lidhur midis OST sh.a. dhe Kontraktorit “Mytilineos S.A.”-Greqi:

Për Nënstacionin Elbasan 3 kanë nisur punimet civile në lidhje me rrugët e kalimit (punime civile për bazamentin e Portalit të Linjës 400 kV (vendosje hekuri, betonim, punime gërmim dheu, punime mbushje).

² Informacion i marre nga Drejtoria e Projekteve të Huaja/Sektori i Projekteve PIU

Ndërsa për Nënstacionin Fier kanë nisur punimet civile për murin mbajtës, portatin, gërmime për rrugët e brendshme etj.

Data e përfundimit të projektit për të dy Lotet është Dhjetor 2025.

✦ Projekti “Programi i Eficiencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit” - Ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë - Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës”:

- Kontrata e Lotit 1 me 2 seksione, është lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe Kontraktorit “EFACEC Engenharia e Sistemas S.A.”- Portugali.
- Kontrata e Lotit 2 me 2 seksione, është lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe Kontraktorit “ENERGOINVEST, d.d-Sarajevo”- Bosnjë & Hercegovina.

Si rezultat i vonesave të konsiderueshme në implementimin e projektit dhe kërkesave të përsëritura nga kontraktorët për kohë dhe/ose kosto shtesë (si rezultat i Forces Madhore: pandemi, lufta Rusi-Ukraine), palët pjesë e projektit si enti financues KfW, Konsulenti Fichtner dhe OST kanë organizur disa mbledhje menaxheriale për të diskutuar dhe vendosur ecurinë e projektit, duke vendosur:

Për lotin 1: OST ka nënshkruar Amendimin Nr. 3, date 21.12.2023 me Kontraktorin Efacec me kohëzgjatje Mars 2024-Gusht 2025 për implementimin e këtij projekti.

Për lotin 2: është amenduar kontrata e zbatimit për shtyrje të afatit kontraktual të përfundimit deri në Korrik 2024 dhe Kontraktori është duke vijuar me punimet civile dhe montim shtyllash sipas grafikut kohor - pjesë e Amendimit OST&Energoinvest.

Sa i përket ecurisë gjatë vitit 2024:

Loti 1

Për seksionin 1: Punimet e parashikuara në nënstationin e Rrashbullit pothuajse kanë përfunduar, tashmë të dy Autotransformatorët janë kolauduar dhe vënë në operim. Me marrjen e njoftimit nga kontraktori për përfundimin e të gjithë punimeve të parashikuara sipas objektit të kontratës, respektivisht për të dy nënstationet Rrashbull dhe Tirana 2, do të vijohet me procesin e kolaudimit dhe lëshimin e çertifikimeve të marrjes në dorëzim për të dy nënstationet.

Për seksionin 2: Për këtë seksion kontraktori është duke vijuar punimet.

Loti 2:

Per seksionin 1 - Punimet janë duke vijuar dhe parashikohen të përfundojnë në fund të muajit Prill 2025, kohë në të cilën do të bëhet energjizimi i linjës.

Për seksionin 2 - Për këtë seksion kontraktori është duke vijuar punimet.

2. Sa i përket investimeve kryesore në rrjetin e OST me fondet e saj, në tabelën më poshtë paraqiten investimet e filluara gjatë vitit 2024 dhe përditësimi i statusit të atyre të filluara në vitet e mëparshme:

Raporti i Pajtuëshmërisë për vitin 2024

| Nr. | Objekti i kontratës | Data e lidhjes së Kontratës | Statusi | Realizimi (%) |
|-----|---|-----------------------------|------------|---------------|
| 1 | Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe 110 kV Burrel - Bulqizë dhe rehabilitimi i Nënstacioneve 110 kV, Burrel dhe Bulqizë | 02.09.2020 | Proces | 76% |
| 2 | Rikonstruksioni i linjes 110 kV Librazhd-Prrenjas | 12.01.2021 | Pefunduar | 100% |
| 3 | Ndërtimi i linjës 110 kV dopjo qark N. Stacioni Elbasan – N. Stacioni Fibër | 18.01.2021 | Proces | 83% |
| 4 | Ndërtimi i linjës së re 110 kV, dopjo qark, Elbasan – Cërrik | 15.02.2021 | Proces | 60% |
| 5 | Ndërtimi i linjës së re 110 kV, me një qark, Lushnje – Fier | 25.02.2021 | Proces | 95% |
| 6 | Upgrade, mirëmbajtje dhe trajnim për sistemin qëndror SCADA/EMS | 19.04.2021 | Proces | 80% |
| 7 | Zgjerimi i kapaciteteve transportuese në pajisjet MPLS (Dizenjimi upgrade dhe konfigurimi i rrjetit) | 05.01.2023 | Proces | 100% |
| 8 | Zhvendosja e linjës 6 kV të fiderit “Tharëse” që del nga N/ST 35/6 kV Fieri 1 | 18.01.2023 | Përfunduar | 100% |
| 9 | Punime për demontimin e tubacioneve nëntokësore të linjave të gazit që kalojnë në territorin ku do ndërtohet Nënstacioni 400/220 kV Fier | 25.01.2023 | Përfunduar | 100% |
| 10 | Platforma për menaxhimin e sigurisë së informacionit dhe eventeve dhe mbrojtja perimetrale | 26.01.2023 | Përfunduar | 100% |
| 11 | Rikonstruksion i disa shtyllave të linjës L.110-40 Fier-Selenicë | 31.01.2023 | Përfunduar | 100% |
| 12 | Ndërtimi i linjës së re 220 kV dopjo qark Fier – Hoxharë, si dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë, bashkë me dy dalje linje 220 kV | 07.02.2023 | Proces | 97% |
| 13 | Furnizim Vendorsje e qarkut të dytë të linjës 220 kV Babicë – TEC Fier | 07.02.2023 | Proces | 38% |
| 14 | Punime civile për rikonstruksionin e NStacionit 110 kV Guri i Kuq, si dhe NStacionit 110 kV Kukës | 13.02.2023 | Përfunduar | 100% |
| 15 | Zhvillimi i skemës dhe rikonstruksioni i Nënstacionit 220/110/35/20 kV Sharrë | 16.02.2023 | Proces | 27% |
| 16 | Blerje mjete teknologjike për mirëmbajtjen e linjave dhe N/Stacioneve | 14.06.2023 | Përfunduar | 100% |
| 17 | Riparimi i linjës kabllore 110 kV N/St. Kombinat – N/St. Selitë | 03.07.2023 | Përfunduar | 100% |
| 18 | Plotësimi i skemës primare të Nënstacionit Golem | 18.08.2023 | Përfunduar | 100% |
| 19 | Rikonstruksion i shtyllave metalike të linjave të tensionit të lartë 400 kV | 24.08.2023 | Proces | 68% |
| 20 | Spostimi i dy linjave kabllore 35 kV, të cilat ndodhen brenda territorit të N/Stacionit të ri 220/110/20 kV Hoxharë | 24.08.2023 | Përfunduar | 100% |
| 21 | Rehabilitimi i sistemit kontrollues të matjes së energjisë elektrike i OST sh.a. | 13.10.2023 | Përfunduar | 100% |

| Nr. | Objekti i kontratës | Data e lidhjes së Kontratës | Statusi | Realizimi (%) |
|-----|---|-----------------------------|------------|---------------|
| 22 | Shtim trakti tretë në N.Stacionin Kombinat | 23.10.2023 | Proces | 27% |
| 23 | Riparimi i linjës kabllore 110 kV NSt. Kombinat – NSt. Selitë, faza e dyte | 10.11.2023 | Përfunduar | 100% |
| 24 | Zgjerim i infrastruktures së rrjetit informatik ekzistues dhe komunikimi me ENTSO-E | 10.11.2023 | Përfunduar | 100% |
| 25 | Rikonstruksion i segmentit të parë të linjes 110 kV Ballsh - Memaliaj | 16.11.2023 | Proces | 20% |
| 26 | Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Burrel | 16.11.2023 | Përfunduar | 100% |
| 27 | Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Elbasan 1 | 20.11.2023 | Përfunduar | 100% |
| 28 | Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Tirana 1 | 20.11.2023 | Përfunduar | 100% |
| 29 | Upgrade Hardware-Software i sistemit të kontrollit të nënstacionit 220 kV Babiçë | 20.11.2023 | Përfunduar | 100% |
| 41 | Rikonstruksion i segmentit të parë të linjës 110 kV Ballsh – Marinëz dhe i linjës Ballsh - Drenovë | 23.11.2023 | Proces | 65% |
| 42 | Zgjerimi i sistemit të monitorimit OPGW në linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV | 18.12.2023 | Përfunduar | 100% |
| 43 | Spostimi i linjave që preken nga gjurma e aksit rrugor Thumanë – Vorë – Kashar dhe instalimi i shtyllave të demontuara në linjën Fier - Rrashbull | 12.01.2024 | Proces | 2% |
| 44 | Përmirësimi i infrastrukturës së Telekomunikacionit të N/ST-ve kryesore (Bateri, ODF, Kondicioner, pajisje etj) | 16.01.2024 | Përfunduar | 100% |
| 45 | Ndërtim i linjës së re 110 kV Gjiri i Lalzit – Fushë Kuqe | 14.02.2024 | Proces | 20% |

4.1.2.1 Përdorimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i rrjetit të fibrave optike (OPGW) si pjesë e rrjetit të transmetimit, për qëllime komerciale

Sistemi i transmetimit të OST ka në përbërje të tij fibër optike (OPGW). Përdorimi i kësaj teknologjie në zhvillimin e sistemit të transmetimit është bërë sipas standarteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare me dy qëllime kryesore:

- Të shërbejë për të bërë mbrojtjen e rrjetit transmetimit ndaj shkarkesave atmosferike.
- Të mundësojë rrugë transporti dhe komunikimi të sigurt dhe të mjaftueshme për vetë OST.

Ky rrjet i fibrave optike (OPGW), është përdorur vetëm për nevojat e OST si më lart përmendur, por, përformanca shumë e mirë e bën atë të aftë të ofrojë shërbime komunikimi edhe për operatorët tjerë potencialë të informacionit, në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Ofrimi nga OST, i rrjetit apo shërbimeve të komunikimeve elektronike, nuk rrezikon sigurinë e funksionimit të rrjetit aktual të transmetimit pasi rrjeti i ri është konceptuar i vecantë për

routime private/ switching³, ku në çdo rast privatësia është e integruar me arkitekturën e sistemit sipas protokollit.

Ky aktivitet është planifikuar të shtrihet fillimisht, vetëm në pjesë të caktuara të shtrirjes së infrastrukturës dhe/ose me sasi të limituar të kapaciteteve brenda vendit. Të ardhurat që do të krijohen nga ky aktivitet do të shërbejnë për zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të komunikimeve elektronike, për të cilat është krijuar një llogari financiare të ardhurash më vete sipas kërkesave të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (neni 23) dhe ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” (neni 35).

Në mbështetje të pikës 4, nenit 55 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, OST i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 5005 prot., date 24.07.2019, për dhënie opinionimi lidhur me përdorimin e infrastrukturës së fibrës optike.

Në përgjigje të saj, ERE me shkresën nr 490/5 prot., date 3.12.2019 ka përcjellë vendimin me nr.194, date 03.12.2019 “Mbi opinionin e ERE-s për kërkesën e OST për dhënien në përdorimin të një pjese të infrastrukturës së Fibrës Optike” në të cilin Bordi është shkrehur për një opinion pozitiv për dhënien e infrastrukturës së fibrës optike për palët e treta, duke patur në konsideratë si vijon:

- Moscënimin e veprimtarisë së OST lidhur me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjitik përfshirë sigurinë kibernetike;
- Kostot për realizimin e këtij aktiviteti të mbulohen nga të ardhurat e realizuara nga kjo duke mos ndikuar në tarifën e transmetimit të energjisë elektrike si dhe në kostot e lidhura me këtë shërbim ndaj klientëve fundore;
- Përcjelljen në ERE të studimit të fizibilitetit përfshirë Planin e Biznesit përfundimtar.

MFE (sot MEKI) në cilësinë e aksionerit të vetëm, me vendim nr. 119, date 6.12.2019, ka miratuar ndryshimet në statutin e OST, duke shtuar në objektin e saj të veprimtarisë: “Zhvillimi dhe funksionimi e shërbimeve të komunikimeve elektronike me shumicë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për shërbimet e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me përcaktimet e autorizimeve që jepen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ku përfshihen: “*Shërbim për ofrimin e transmetimit të të dhënave, të disponueshme për publikun.*”

Për të garantuar ecurinë e këtij projekti të rëndësishëm, OST ka bërë pjesë të strukturës organizative Drejtorinë e Shërbimeve të Telekomunikacionit e cila më parë ka qenë e organizuar si sektor.

Për ofrimin e këtij shërbimi nga OST, janë marrë miratimet e nevojshme, si më poshtë:

- OST është pajisur me Autorizimin e Përgjithshëm nga AKEP sipas Çertifikatës së Konfirmimit të Njoftimit Nr. 2020_AP-001051/datë 03.03.2020;
- Me Vendimin të Këshillit Mbikqyrës të OST dhe MF, janë miratuar çmimet e shërbimeve kombëtare që OST do të ofrojë, në fushën e komunikimeve elektronike.

³ Material i siguruar nga Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit

- OST ka krijuar një llogari financiare të ardhurash më vete, sipas kërkesave të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 23, për ndarjen e llogarive.

Me vendim nr. 5, datë 20.04.2023 të Këshillit Mbikqyrës të OST dhe vendim nr. 31, datë 02.06.2023 të Asamblesë së Aksionarit të OST sh.a., janë miratuar çmimet e reja të shërbimeve që ofron OST në fushën e komunikimeve elektronike, të cilat janë reflektuar dhe në kontratat e lidhura në vijim.

Sa i përket ecurisë gjatë vitit 2024:

Në muajin Korrik 2024, në zbatim të Vendimit të ERE-s nr. 194, datë 03.12.2019, OST ka informuar ERE-n mbi ecurinë e dhënies në përdorim të një pjese të infrastrukturës së fibrës optike, me anë të shkresës nr.4210 prot., datë 31.07.2024.

Në vijim të shkresës nr. 861/2 prot., datë 09.10.2024 të ERE, ku ndër të tjera, është lënë si rekomandim për ZP që: *“në kuadër të garantimit të pavarësisë financiare të OST sh.a. të kërkojë nga OST sh.a. për të përfshirë një analizë më të plotë të zbatimit të vendimit të ERE-s nr. 194, date 03.12.2019, ku të evidentohet mënyra e përdorimit të të ardhurave të gjeneruara nga përdorimi i infrastrukturës së fibrës optike nga palët e treta”*, i është kërkuar Drejtorive përkatëse, kryerja e një analize të tillë, e cila i është vënë në dispozicion Zyrtarit të Pajtueshmërisë.

Përgjatë vitit 2024, OST ka kontrata të lidhura për ofrimin e shërbimit “LAN 2 LAN” me 6 subjekte, të tilla si: KESH sh.a., Kurum, shoqërinë Voltalia Albanie shpk, OPTIXCOM shpk, Abissnet, dhe ATU.

Aktualisht, OST ka ende kapacitete të lira për t’u shfrytëzuar, të cilat do të vazhdojnë të jepen me qira nga OST, në funksion të planit të biznesit të krijuar për këtë qëllim.

Në lidhje me masat e marra mbi sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik, përfshirë sigurinë kibernetike, në çdo rast të vënies në dispozicion të kapaciteteve transmetuese të rrjetit të të dhënave me fibër optike për të tretët, zhvillimi i një kuadri dhe mekanizmash për të parandaluar dhe reaguar ndaj sulmeve kibernetike, ka qenë një nga detyrat kryesore të Drejtorisë së Shërbimeve të Telekomunikacionit, e mbështetur nga Sektori për sigurinë kibernetike në OST.

Ndër masat e konsideruara, përmendim si vijon:

- Zbatimi rigoroz i rregullave të menaxhimit të Access-it bazuar në nevojën për të hyrë në sistem;
- Minimizimi i aksesit fizik në komponentët kritikë për OST;
- Vendosja e nivelit shtesë aksesit për elementët thelbësore të rrjetit;
- Mbyllja e shërbimeve dhe protokolleve të papërdorura;
- Përditësimi i versionit më të fundit në elementët të rrjetit, bazuar në rekomandimin e prodhuesit;
- Vendosja e regjistrimit të sinjalizimeve në mënyrë që regjistrat të jenë të sigurtë;
- Ndërtimi i sistemeve të menaxhimit dhe monitorimit për rrjetin TLC;
- Zbatimi i Procedurave për menaxhimin e incidenteve, duke përfshirë llojin e incidentit, objektivat, rolin dhe përgjegjësitë dhe përshkallëzimi sipas

- niveleve organizative në OST, bazuar në politikën (POL-INFOSEC-001 Politika për sigurinë e sistemeve informatike të ost v2 0);
- Vendosja e sistemeve të akses kontrollit dhe sistemit të survejimit me kamera në ambientet teknologjike, ku ndodhen pajisjet e SCADA apo sistemi Mini SCADA, bazuar në politikën (POL-INFOSEC-005 Politika e sigurisë së dhomës së server-ave);
 - Krijimin e ekipit përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike (CSIRT) dhe vënien në dijeni e autoritetit (AKCESK) për çdo incident nga marrja e këtij raporti. Ekipi CSIRT është pjesë e e strukturës së Departamentit të Operimit të Sistemit (SCADA).
 - Përdorimi i mekanizmave të vecanta të autentikimit dhe kredenciale për përdoruesit e rrjetit në sistemet industriale dhe rrjetit të korporatës, bazuar në ISO 27001 Information Security Management System.

Gjatë vitit 2024 nuk është shënuar asnjë incident ose prishje e Indikatorëve Kyç të Performancës (KPI) për shërbimet e brendshme të sistemit energjetik, pavarësisht ngarkesës së lartë të sulmeve kibernetike në portalet qeveritare dhe institucionet e tjera.

4.1.3 Akses i Palëve të Treta në sistemin e transmetimit

OST duhet të sigurojë akses të barabartë në sistemin e transmetimit për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit, në përputhje me kërkesat e vendosura tek Ligji Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, i ndryshuar, aktet e tjera ligjore në fuqi si dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit. Në këtë mënyrë realizohet pajtueshmëria me një ndër shtyllat kryesore të Programit të Pajtueshmërisë që është pikërisht shmangia e sjelljeve diskriminuese.

Për të parë respektimin e këtij detyrimi nga OST, janë monitoruar procedurat e aplikimit për lidhje të reja në rrjetin e transmetimit.

Për sa i takon procedurave për lidhje të reja në rrjetin e transmetimit, si dhe statusit të ketyre aplikimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2024, ka patur një sërë aplikimesh për mundësinë e lidhjes së centraleve prodhuese të energjisë elektrike në zona të ndryshme të sistemit elektroenergjetik, të paraqitura në tabelën si vijon⁴:

- ▶ Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik”, 4 aplikime, fuqia totale e kërkuar 46 MW, realizuar 3 Marrëveshje Lidhjeje;
- ▶ Centrale të tipit “Gjenerues Solar”, 69 aplikime, fuqia totale e kërkuar 3793.97 MWp, realizuar 4 Marrëveshje Lidhjeje;
- ▶ Centrale të tipit “Gjenerues Eolik”, 23 aplikime, fuqia totale e kërkuar 2618.4 MW, nuk është realizuar asnjë Marrëveshje Lidhjeje;
Të gjitha aplikimet për këtë kategori kanë qenë për ndërtimin e tyre në tokë;
- ▶ Centrale të tipit “Gjenerues Termik” nuk ka pasur aplikime dhe nuk është realizuar asnjë Marrëveshje Lidhjeje.
- ▶ Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik me sistem rezerve pompimi” 1 aplikim, fuqia totale e kërkuar 1620 MW, nuk është realizuar asnjë Marrëveshje Lidhjeje.

⁴ Informacion i marrë nga Drejtoria e Planifikim Zhvillimit të Rrjetit të Transmetimit

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë vënë në operim tre burime gjeneruese, të tipit solar të lidhur në rrjetin e transmetimit me tension 110 kV dhe janë nënshkruar marrëveshje lidhje në sistemin e transmetimit 15 centrale.

Sa i përket trajtimit të kërkesave brenda afateve të parashikuara në “Rregulloren e Procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST dhe përdoruesit si dhe marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a dhe përdoruesit”, miratuar me Vendim të Bordit të ERE nr.87, datë 20.04.2018, nga informacioni i vënë në dispozicion, rezulton se:

Në rastet e kërkesave për lidhje që janë trajtuar sipas VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni” i ndryshuar me VKM nr.718, datë 12.10.2016, OST është shprehur nëpërmjet një opiniononi paraprak sikundër parashikon pika 2.a e nenit 10 të VKM-së.

Gjithashtu, janë trajtuar dhe kërkesat për lidhje me rrjetin e transmetimit, të centraleve eolike në kuadër të procedurës konkurruese për përzgjedhjen e projekteve për “*Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 MW dhe 100 MW (përfshirë), të cilët do të përfitojnë nga masat mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë*”, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të finalizuar në muajin Korrik 2024 si vijon:

- Shoqëria Voltalia s.a ka marrë miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Centralit Eolik South Wind Park, me fuqi të instaluar 75 MW.
- Konsortiumi Guris Insaat Ve MUhendislik A.S, "Morgan Energji Yatirim Holding A.S" dhe "Brd Energy" sh.p.k ka marrë ri-miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Kryevidh, me fuqi të instaluar 74.4 MW.
- Shoqëria Verbund Green Power Albania SHPK ka marrë ri-miratimin në parim për lidhjen me rrjetin e transmetimit të Parkut Eolik Kryevidh, me fuqi të instaluar 72.6 MW.

Tarifat e lidhjes në rrjetin e transmetimit janë tarifa fikse siç përcaktohen në “Rregulloren e Procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit” e miratuar nga Bordi i ERE-s, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe eficiente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit.

4.1.4 Pajtuëshmëria e përdoruesve të rrjetit me Kodin e Transmetimit

Në zbatim të rekomandimeve të ERE-s lënë për Zyrtarin e Pajtuëshmërisë, përcjellë me shkresën nr. 861/2 prot., datë 09.10.2024, në këtë kapitull do të trajtohet pajtuëshmëria e përdoruesve me kodin e transmetimit, në kuadër të transparencës dhe trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit të transmetimit.

Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendim të ERE nr. 63, datë 11.04.2022, përcakton në mënyrë të hollësishme normat që shërbejnë për të siguruar mbarëvajtjen e operimit dhe zhvillimit të sistemit të transmetimit, si dhe përcakton kushtet e shërbimit që ofrohen nga OST

ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit. Të drejtat dhe detyrimet reciproke për OST dhe përdoruesit, përcaktohen në Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, Kodin e Transmetimit, marrëveshjet dy/shumëpalëshe, si dhe vendimet e rregulloret e tjera të miratuara nga Bordi i ERE.

Kodi i Transmetimit parashikon metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit, kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit si dhe detajon specifikimet minimale teknike dhe funksionale për dhënien e aksesit dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të centraleve prodhuese, të Operatorit të Shpërndarjes dhe të konsumatorëve të rëndësishëm.

Në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit, Neni 6 pika 3, OST monitoron zbatimin e Kodit të Transmetimit nëpërmjet kryerjes së inspektimeve, testimit të sistemeve dhe proceseve apo mbledhjes së informacionit të nevojshëm nga përdoruesit e sistemit të transmetimit, për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit të Transmetimit nga këta përdorues.

Në çdo rast pajtueshmërie, OST njofton përdoruesin dhe informon ERE për:

- a. pajtueshmërisë së konstatuar;
- b. informacionin/shpjegimin e përdoruesit në lidhje me pajtueshmërinë e konstatuar (nëse ka);
- c. afatet kohore të nevojshme për zbatimin e detyrimeve nga përdoruesi, të domosdoshme për të zgjidhur situatën e pajtueshmërisë me dispozitat e kodit.

Gjatë monitorimeve on-site, OST vlerëson kërkesat të cilat lidhen kryesisht me operimin në kohë reale të sistemit, kërkesa të cilat janë të lidhura ngushtësisht me zbatimin e kërkesave në pikën e lidhjes.

Sipas informacionit të marre pranë Sektorit të Zbatimit të Kodeve/Drejtoria e Drejtimit Operativ të Sistemit, gjatë vitit 2024, janë monitoruar kategorite e përdoruesve të rrjetit si vijon:

- i. Gjeneruesit (HEC) gjithsej 17 subjekte të monitoruar;
- ii. Konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit, gjithsej 4 subjekte të monitoruar;
- iii. Përdorues të lidhur në rrjetin e OSSH me tre kategori të ndryshme (PV + Konsumator + HEC), gjithsej 6 subjekte të monitoruar.

Gjatë monitorimeve mbi zbatimin e kërkesave të Kodit, janë hasur disa problematika që kanë ndikuar në përmbushjen e kërkesave dhe standardeve të përcaktuara. Këto sfida lidhen me aspekte të ndryshme teknike dhe organizative, të cilat kërkojnë një përpjekje të koordinuar për t'u adresuar dhe përmirësuar. Disa nga pajtueshmerite e konstatuara kanë të bëjnë me:

- Mosrespektimin e afateve të raportimit nga disa përdorues;
- Ndryshimet në kërkesat teknike dhe infrastrukture;
- Mungesa e përgatitjes teknike në raste të caktuara.

Nëpërmjet monitorimeve, OST sh.a. ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin dhe performancën e përdoruesve të rrjetit të transmetimit, duke monitoruar, komunikuar dhe udhëzuar sipas rastit, me qëllim rritjen e sigurisë operacionale, evitimin e ngjarjeve shqetësuese në sistem dhe përmirësimin e funksionimit të të gjithë sistemit elektroenergjetik. Komunikimi

me përdoruesit ka qenë i vazhdueshëm dhe në çdo rast prej tyre është kërkuar që planifikimi dhe operimi i aseteve të tyre të bëhet bazuar në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit. Në asnjë rast përdoruesit nuk na janë shprehur se nuk do t'i përmbushin detyrimet që përcakton Kodi i Transmetimit; madje ata kanë shprehur angazhim se do t'i përmbushin detyrimet.

OST sh.a. është përpjekur që papajtuëshmëritë t'i zgjidhë nëpërmjet komunikimit dhe si rrjedhojë ka vijuar me procedurën e takimeve në ambientet e OST sh.a., me përfaqësues të lartë të përdoruesve, duke i parashtruar qartë kërkesat, detyrimet e Kodit të Transmetimit dhe si rrjedhojë penalizimet nëse këto kërkesa nuk përmbushen.

Për çdo papajtuëshmëri të konstatuar gjatë monitorimeve të realizuara gjatë vitit 2024, OST ka komunikuar me përdoruesit nëpërmjet shkresave zyrtare, ku për dijeni është vënë gjithashtu edhe Enti Rregullator i Energjisë.

Në vijim të monitorimeve të realizuara dhe komunikimeve intensive me përdoruesit, vihen re një ndërgjegjësim në disa përdorues, të cilët për kohë të gjatë nuk kishin marrë asnjë masë në përmbushjen e kërkesave, qoftë në aspektin teknik, siç është realizimi i lidhjes me rrjetin e telekomunikacionit apo SCADA, shkëmbimi i të dhënave gjatë planifikimit-zhvillimit, dispeçerimit apo edhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Lidhjes.

Përmirësime janë konstatuar në shkëmbimin e të dhënave:

Marrja e të dhënave të duhura bazuar në parashikimin e gjenerimit dhe ngarkesave (duhet vlerësuar se tashmë më shumë se 70% e përdoruesve e përcjellin planin afatgjatë dhe afatshkurtër sa herë që OST e ka kërkuar), duke bërë të mundur saktësinë e parashikimeve që OST bën në analizat e sigurisë.

Marrja e informacionit në kohë reale:

Si rezultat i komunikimeve të deritanishme ndërmjet përdoruesve dhe OST, është arritur që shumica e përdoruesve të përcjellin të dhëna në kohë reale në OST.

Nënshkrimi i marrëveshjes së lidhjes:

Si rezultat i masave të marra në vijim të monitorimeve të realizuara dhe komunikimeve intensive me përdoruesit, ka patur rezultat edhe në vijimin e procesit të nënshkrimit të marrëveshjeve të lidhjes me përdorues të cilët, për arsye të ndryshme, procesi kishte mbetur pezull. Në marrëveshjet e lidhjes, përdoruesit kanë marrë përsipër të zbatojnë të gjitha detyrimet që lindin nga Kodi i Transmetimit dhe Kodi i Lidhjes, të cilat përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, zbatimin e menjëhershëm të urdhërave të Qendrës Dispeçer, si dhe menaxhimin e nënstacioneve të tyre me personelin e vet, i cili duhet të ketë kualifikimin e përshtatshëm, në respekt të plotë të Kodit të Transmetimit

Si konkluzion, nga ana e OST janë ndërmarrë hapat dhe procedurat e kërkuara nga Kodi i Transmetimit me qëllim mbikqyrjen e zbatimit dhe pajtuëshmërinë me kërkesat e Kodit. Në çdo rast të konstatimit të papajtuëshmërisë, është bërë njoftimi i përdoruesve të rrjetit dhe Entit Rregullator të Energjisë, si dhe është kërkuar marrja e masave të duhura për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nëpërmjet marrëveshjes së lidhjes dhe Kodit të Transmetimit. Si rezultat i këtyre monitorimeve, është arritur përmirësimi i kushteve dhe përmbushja e

detyrimeve nga një numër i madh i përdoruesve të rrjetit, sikurse janë masat e përshkruara me lart.⁵

4.1.5 Tregu Balancues i Energjisë Elektrike

Nga data 1 Prill 2021, bazuar në Rregullat e Tregut të Balancimit miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020, OST operon Tregun Shqiptar të Balancimit në të cilin organizohen procedurat respektive për sigurimin e kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese me qëllim balancimin e sistemit. Në përmbushje të këtij detyrimi OST bën evidentimin e aktivizimeve, disbalancave dhe menaxhimin kontraktual e financiar të tyre me palët përgjegjëse për disbalancat dhe me ofruesit përkatës të shërbimeve të balancimit.

Tregu shqiptar i balancimit ka mundur kalimin përfundimtar nga një mekanizëm i rregulluar me entitete publike në një liberalizim të tregut të energjisë balancuese, ku çdo palë ofruese e shërbimeve të balancimit mund të marrë pjesë dhe të bëhet konkurrese me produktet e saj për shërbimet e balancimit.

4.1.5.1 Pjesëmarrësit e tregut të energjisë

Në përmbushje të detyrimit për akses të barabartë në sistem, OST kryen dhe ndjek procesin e regjistrimit të të gjithë pjesëmarrësve të tregut në bazë të Rregullores për regjistrim në tregun shqiptar të energjisë elektrike (miratuar me Vendim të ERE nr. 160, datë 12.10.2017).

Pjesëmarrësit e tregut kanë nënshkruar me OST kontratën për shërbimin e transmetimit (kontratë tip) miratuar nga ERE me Vendim nr.23 datë 15.02.2017, ndryshuar me Vendim nr.99 datë 04.07.2017, me një tarifë të përcaktuar për vitin 2024, të miratuar nga ERE me vendim nr. 72, datë 13.04.2022 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024”.

Të dhëna e lartpërmendura janë të publikuara edhe në website-in zyrtar të OST. Kjo marrëveshje siguron shërbimin e transmetimit për pjesëmarrësit të tregut në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në programin e pajtuëshmërisë.

Nga data 12 Prill 2023, në vijim të zhvillimeve në Sektorin Elektroenergjetik, pas miratimit nga ERE të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e Alpex, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit, si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes) me Vendimin Nr. 347, datë 27.12.2022, nga OST është bërë njoftimi për pjesëmarrësit e tregut të energjisë duke sqaruar se:

- (i) në përputhje me parashikimet e Vendimit të ERE Nr. 126, datë 17.05.2021 “Mbi Miratimin e Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me Shumicë të Energjisë (Remit)”, çdo Pjesëmarrës Tregu apo aplikues i ri duhet të regjistrohet pranë Entit Rregullator të Energjisë në regjistrin e REMIT;
- (ii) Për t’u regjistruar si “Palë Përgjegjëse Balancuese” çdo palë e interesuar duhet të plotësojë formularët e publikuar në faqen zyrtare të OST sh.a., me plotësimin e të

⁵ Për më tepër, shih raportin e përcjellë ERE-s me anë të shkresës nr.654 prot., datë 27.01.2025

cilëve do të vijohet me nënshkrimin e Marrëveshjes për Palën Përgjegjëse Balancuese për regjistrim në Tregun Shqiptar të Balancimit.

Gjithë dokumentacioni dhe informacioni i nevojshëm për palët është i publikuar në faqen zyrtare të OST në rubrikën “Tregu i Shqiptar i Balancimit”.

Në vijim të këtij procesi, lista e subjekteve të regjistruar në tregun balancues të energjisë elektrike si Palë, Grup Përgjegjës për Balancim apo Ofrues i Shërbimit të Balancimit për vitin 2024, paraqitet më poshtë:

Regjistri i Ofruesve të Shërbimit të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit:

| Nr. | Kodi | Kompania |
|-----|----------|--|
| 1. | PPB-001 | GSA sh.p.k |
| 2. | PPB-003 | ReNRGY Trading Group sh.p.k. |
| 3. | PPB-005 | GEN-I Tirana sh.p.k. |
| 4. | PPB-007 | Energji Ashta sh.p.k. |
| 5. | PPB-009 | Danske Commodities Albania sh.p.k. |
| 6. | PPB-010 | NOA Energy Trade sh.p.k. |
| 7. | PPB-011 | Ayen Energy Trading Sh.a |
| 8. | PPB-012 | Ayen AS Energji Sh.a |
| 9. | PPB-013 | EZ-5 Energy shpk |
| 10. | PPB-014 | AXPO Albania Sh.a |
| 11. | PPB-015 | KESH sh.a |
| 12. | PPB-016 | Energy Financing Team Tirana shpk |
| 13. | PPB-018 | Kurum International SHA |
| 14. | PPB-019 | ENER TRADE Sh.p.k |
| 15. | PPB-020 | FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË sh.a. |
| 16. | PPB-021 | Devoll Hydropower sh.a. |
| 17. | PPB-023 | OPERATORI I SITEMIT TE SHPERNDARJE sh.a. |
| 18. | PPB-027 | Lengarica &Energy sh.p.k |
| 19. | PPB-030 | TIRANA INTERNATIONAL DEVELOPMENT shpk |
| 20. | PPB-031 | INFO Telecom sh.p.k. |
| 21. | PPB-032. | DITEKO sh.p.k |
| 22. | PPB-033 | Spe Gjadër sh.p.k. |
| 23. | PPB-034 | FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL Sh.a |
| 24. | PPB-035 | AlbEsp Trading & Consulting sh.p.k. |
| 25. | PPB-037 | Hec-i Bishnica1,2 sh.p.k. |
| 26. | PPB-038 | Heci Tervolit sh.p.k. |
| 27. | PPB-039 | ADA Solar SE sh.p.k. |
| 28. | PPB-040 | Lajthiza Invest Sh.a |
| 29. | PPB-041 | FUTURE ENERGY TRADING AND DYNAMICS sh.p.k. |
| 30. | PPB-042 | DRAGOBIA ENERGY sh.p.k. |
| 31. | PPB-043 | Korça Photovoltaik Park sh.p.k. |
| 32. | PPB-044 | SUN BEAT SYSTEM sh.p.k. |
| 33. | PPB-045 | New Technolgy Solution Production (NTSP) sh.p.k. |
| 34. | PPB-046 | TREN SUN SYSTEM sh.p.k. |
| 35. | PPB-051 | ENERGY 24 sh.p.k. |
| 36. | PPB-052 | ENSCO Trading (Albania) sh.p.k. |
| 37. | PPB-056 | NATYRE ENERGY sh.p.k. |
| 38. | PPB-057 | G.S.K sh.p.k. |

| Nr. | Kodi | Kompania |
|-----|----------|--|
| 1. | PPB-001 | GSA sh.p.k |
| 39. | PPB-058 | PROINFINIT CONSULTING sh.p.k. |
| 40. | PPB-059 | SOLE 24 DOOEL Shkup-Dega në Shqipëri |
| 41. | BRP-060 | Duferco Shqipëria sh.p.k. |
| 42. | PPB-061. | KARAVASTA SOLAR sh.p.k |
| 43. | PPB-062 | SPV BLUE 1 sh.p.k. |
| 44. | PPB-063 | PROTERGIA ENERGY ALBANIA sh.p.k. |
| 45. | PPB-064 | NOVA SOLAR SYSTEM sh.p.k. |
| 46. | PPB-065 | ALB ENERGY TRADE sh.p.k. |
| 47. | PPB-066 | Energy Commodities sh.p.k. |
| 48. | PPB-067 | MFT ENERGY KOSOVO |
| 49. | PPB-068 | 5GX ENERGY sh.p.k. |
| 50. | PPB-069 | YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA sh.p.k. |
| 51. | PPB-070 | NRG Power sh.p.k. |
| 52. | PPB-071 | JUANA sh.p.k. |
| 53. | PPB-072 | GreeNNAT Solar Park Ballsh sh.p.k. |
| 54. | PPB-073 | ERSEKA SOLAR PARK 1 sh.p.k. |

Regjistri i Ofruesve të Shërbimit të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit:

| Nr. | Kodi i regjistrimit | Kompania |
|-----|---------------------|--|
| 1. | OSHB-001 | Ayen As Energji Sh.a |
| 2. | OSHB-002 | KESH sh.a |
| 3. | OSHB-004 | Devoll Hydropower sh.a. |
| 4. | OSHB-005 | Hydropower sh.a Kurum International Sh.a |

Regjistri i Grupeve të Balancimit të Tregut Shqiptar të Balancimit:

| Nr. | Emërtimi i Grupit të Balancimit |
|-----|--|
| 1 | Grupi i Balancimit KESH sh.a. |
| 2 | Grupi i Balancimit GSA Sh.p.k |
| 3 | Grupi i Balancimit "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË sh.a |
| 4 | ALB ENERGY TRADE sh.p.k |
| 5 | GEN-I Tirana sh.p.k |
| 6 | FUTURE ENERGY TRADING AND DYNAMIC sh.p.k |
| 7 | ENER TRADE sh.p.k |

4.1.5.2 Prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit

Referuar ligjit për sektorin e energjisë, rregullave të tregut, rregullave të balancimit si dhe akteve të tjera rregullatore, OST prokuron energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit si dhe për rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.456, datë 29.6.2022 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve

në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, u vendos që gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim me energji elektrike (deri në 31 Dhjetor 2022), vendosur me VKM Nr. 584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike” (i ndryshuar), sasia e energjisë për mbulimin e humbjeve do të sigurohej nga shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, pra KESH. Kjo shoqëri furnizon Operatorin e Sistemit të Transmetimit me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, me çmimin e rregulluar të blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, ku çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi do të jetë 8565.2 Lekë/MWh, (për periudhën 02.07.22 – 08.02.2023) dhe 10,000 Lekë/MWh (për periudhën 09.02.23 – 11.04.2023). Kjo sasi energjie është siguruar në bazë të kontratës ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me nr. Prot 4670 date 27.07.2022 dhe e miratuar nga ERE me vendimin nr. 230 datë 12.09.2022.

Edhe për periudhën 01.01.2023 - 11.04.2023, në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, sasi të e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit janë siguruar nga KESH me çmimin e rregulluar të blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike, ku çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që i është paguar prodhuesve ekzistues me përparësi ka qenë 8565.2 Lekë/MWh, (për periudhën 01.01.23 – 08.09.2023) dhe 10,000 Lekë/MWh (për periudhën 09.02.23 – 11.04.2023).

Prej datës 12 Prill 2023 prokurimi i energjisë për mbulimin e humbjeve kryhet nëpërmjet platformës ALPEX, ku ALPEX do të sigurojë shlyerjen e volumit të kontraktuar në ALPEX DAM, sipas Rregullave të Tregut dhe, nëse, çmimi klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM është më i lartë se çmimi i kontratës (me KESH sh.a), Shitësi do të kompensojë Blerësin për diferencën midis çmimit klerues për ato Njësi Kohore të Tregut në DAM dhe çmimit të kontratës.

Nga verifikimi i faqes online te OST rezulton që është pasqyruar i gjithë informacioni i duhur për procesin e prokurimit të humbjeve, si dhe rezultatet e dala nga prokurimi, duke ju përmbajtur kërkesave të përcaktuara në pikat 25 dhe 35 të Programit të Pajtueshmërisë.

4.1.5.3 Ankandet mbi alokimin e kapaciteteve

OST si Operator i Sistemit të Transmetimit në Republikën e Shqipërisë, është i ngarkuar të përcaktojë vlerat e kapacitetit transmetues ndërkufitar dhe rakordimin e tyre me TSO-të fqinje në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ENTSO-E (Rrjeti European i Operatorëve të Transmetimit të Energjisë Elektrike).

Në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi kushtet për hyrjen në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike” dhe Traktatit të Komunitetit të Energjise, Zyra Rajonale e Alokimit të Kapaciteteve “SEE CAO” realizon procedurat e ankandëve për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit në të dyja

drejtimet, ndërmjet Zonave të Kontrollit të OST-ve Pjesëmarrëse të Europes Juglindore, ku OST merr pjesë si bashkëpronare me vota të barabarta. Nëpërmjet ankandave të zhvilluara në këtë zyrë, është bërë alokimi i kapaciteteve ndërkufitare në të dy drejtimet, për kufirin AL-Greqi dhe AL-Mal i Zi, në bazë të “Rregullave të Harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyren e Koordinimit të Ankandave të Kapacitetit të Interkonjeksionit në Europen Juglindore SEE CAO”.

Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lidhjes së KOSTT me ENTSO-E, Kosova njihet si zonë kontrolli e pavarur, ku në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit - OST dhe bazuar në marrëveshjen për krijimin e bllokut të kontrollit Shqipëri-Kosovë, operojnë brenda këtij blloku, në përputhje me rregullat e ENTSO-E. Me njohjen e KOSTT si zonë kontrolli, të gjithë proceset ndërkufitare zhvillohen me kufirin OST-KOSTT.

Në vazhdimësi të këtyre hapave, KOSTT ka njoftuar SEE CAO-n mbi vendimin e RGCE për hyrjen në fuqi të marrëveshjes së lidhjes së KOSTT me ENTSO-E dhe qëllimin e KOSTT për të firmosur marrëveshjen e shërbimeve me SEE CAO për vitin 2021.

SEE CAO ka përgatitur ndryshimet përkatëse të Rregullave të Harmonizuara të Alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të SEE CAO, me qëllim aplikimin e tyre në kushtet e përfshirjes edhe të KOSTT si përfituese e shërbimeve të SEECAO.

Me vendim nr. 280, date 01.11.2022, Bordi i ERE ka miratuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të SEE CAO, për kufijtë Shqipëri-Greqi, Shqipëri-Mali i Zi dhe Shqipëri-Kosovë si dhe anekset e këtij dokumenti, të cilat aplikohen nga data 1 Janar 2023.

Ky proces monitorohet nga ERE, sipas përcaktimeve të rregullave të lartpërmendura. OST e konkretisht Drejtoria e Shërbimeve të Tregut gjatë vitit 2024 ka dërguar informacion periodik çdo 3 muaj, në rrugë elektronike mbi procedurat e ankandave të zhvilluara nga OST.

Nga monitorimi i kryer, rezulton se në faqen zyrtare të OST është publikuar i gjithë informacioni mbi ankandet për alokimin e kapaciteteve sipas përcaktimeve të pikës 9 të Rregullave për alokimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, konstatohet se ky proces i kryer nga OST, i ka ofruar shërbimin të gjithë pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, me të njëjtat terma dhe kushte dhe në mënyrë jodiskriminuese.

4.1.5.4 Palët përgjegjëse për balancim

Një nga detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të përcaktuara shprehimisht në Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike, është kryerja e balancimit të sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe rregullat e tregut.

Në bazë të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 106, date 02.07.2020, OST është përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë së sistemit dhe për prokurimin e shërbimeve balancuese nga ofruesit e shërbimeve të balancimit (OSHB) në mënyrë që të garantojë sigurinë operacionale në sistem.

Krijimi i tregut të balancimit:

Krijimi dhe vënia në funksionim e Tregut të Balancimit të energjisë elektrike, në kohë reale për Shqipërinë (ABM) është një hap i rëndësishëm për sektorin elektroenergjitik në vend, në përputhje me detyrimet e Shqipërisë përballë Traktatit të Komunitetit të Energjisë si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit – WB6 MoU (i nënshkruar midis Operatorëve të Sistemit të Transmetimit, Autoriteteve Rregullatorë Kombëtare në fushën e energjisë, Bursave të Energjisë (PX) dhe Ministrive përgjegjëse për energjinë të shteteve përkatëse të Ballkanit Perëndimor si pjesë e procesit "WB6" të drejtuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

ERE me Vendim Nr. 106, datë, 02.07.2020 "Mbi miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike" ka miratuar këto rregulla, të cilat ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike pa efekte financiare deri në datën 31.12.2020, datë e cila u shty me Vendimin e ERE nr. 275, datë 28.12.2020", sipas të cilit Tregu Shqiptar i Balancimit, do të ishte funksional më datën 1 Prill 2021.

Nga data 1 Prill 2021, OST ka implementuar tregun balancues konform rregullave të tregut shqiptar të balancimit dhe shërbimet balancuese aktualisht prokurohen me bazë tregu.

Tregu i Balancimit i lejon OST të përmbushë detyrimet e saj lidhur me balancimin e sistemit në kohë reale duke siguruar shërbimet e nevojshme në kohë reale bazuar në parimet e tregut të hapur, transparent dhe jodiskriminues.

Në këtë kuadër, OST kryen nëpërmjet SEE CAO:

- Ankandet e Angazhimit për Disponueshmëri për sigurimin e kapacitetit rezervë për balancimin e sistemit si dhe për llogari të KOSTT, referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT;

- Ankandet e Angazhimit për Shpërndarje për sigurimin e energjisë balancuese për balancimin e sistemit si dhe për llogari të KOSTT, referuar marrëveshjes për ndarjen e rezervave OST-KOSTT.

Mbi zbatimin e marrëveshjes për shlyerjen financiare të devijimeve ndërkufitare:

Në vijim të përmbushjes së detyrimeve që OST ka si palë e ENTSO-E, OST si operatori në qendër të mekanizmit balancues, përgjegjës për ruajtjen e balancës së sistemit elektroenergjitik, është gjithashtu përgjegjës për shkëmbimin ose ndarjen e shërbimeve të balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të shteteve fqinj.

Në zbatim të Marrëveshjes FSKAR për shlyerjen financiare të devijimeve ndërkufitare, të nënshkruar nga të gjitha TSO-të e zonës sinkrone Europiane dhe vendimit të ENTSO-E, OST ka filluar implementimin e saj prej datës 1 Qershor 2021, ku kompensimi i devijimeve të paqëllimshme ndërkufitare, nuk do të bëhet më tej në natyrë, por palët (TSO-të) do të kompensojnë njëra-tjetrën financiarisht.

Përsa më sipër, janë njoftuar gjithë pjesëmarrësit e tregut se duhet të deklarojnë skedulim të balancuar duke patur parasysh faktin që janë financiarisht përgjegjëse për disbalancat kundrejt OST, sikurse rrjedhimisht OST është financiarisht përgjegjëse për devijimet në interkonjeksion kundrejt zonës sinkrone.⁶

⁶ Informacion i marrë pranë Drejtorisë së Shërbimeve të Tregut

Nga monitorimi rezulton se marrëdhënia e OST me palët përgjegjëse për balancim, rregullohet mbi baza transparence dhe mosdiskriminimi. Gjithë informacioni i nevojshëm mbi këtë proces është i publikuar në website-in e OST.

4.2 Konfidencialiteti i të dhënave dhe i informacionit të ndjeshëm tregtar

Referuar pikës 28 të Programit të Pajtueshmërisë, OST duhet të sigurojë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të siguruar nga OST gjatë aktiviteteve funksionale dhe/ose komerciale dhe duhet të marrë të gjitha masat e arsyeshme dhe të nevojshme për të shmangur shpërndarjen diskriminuese të informacionit të ndjeshëm tregtar në lidhje me aktivitetet të cilat përmbajnë vlera tregtare për persona të tjerë.

Për të verifikuar përmbushjen e këtij detyrimi, është kërkuar informacion mbi sistemet e teknologjisë së informacionit që OST ka në administrim, të dhënat që hidhen në këto sisteme si dhe të dhënat që merren nga palët e treta nëpërmjet këtyre sistemeve.

4.2.1 Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Një nga funksionet kyçe të Operatorit të Sistemit të Transmetimit është të zhvillojë sistemin e transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me energji elektrike si dhe të koordinojë zhvillimin e rrjetit si brenda vendit ashtu dhe me fqinjët. Programet dhe sistemet kompjuterike të cilat shërbejnë për komandimin apo monitorimin e rrjetit elektrik zënë një vend të vecantë dhe janë në fokus të vazhdueshëm përse i përket sigurisë së tyre apo përditësimeve që nevojiten. Gjithashtu OST zotëron një rrjet të brendshëm të transmetimit të të dhënave i cili përbëhet nga kablla OPGW të pajisur me fibra optike për lidhjet midis nënstacioneve dhe nga kablla LAN për rrjetet lokale të njësive apo nënstacioneve të OST.

OST ka në pronësi dhe përdor disa sisteme kompjuterike të cilat shërbejnë për menaxhimin e rrjetit energjetik brenda vendit si dhe në linjat e interkonjeksionit. Gjithashtu OST zotëron edhe sisteme të cilat shërbejnë për shkëmbimin e informacionit me të tretët siç janë ENTSO-E, KESH sh.a., Operatorët e ndryshme privat apo shtetëror, Hec-e apo nënstacione.

Sistemi SCADA/EMS (Qendra Kombëtare e Kontrollit)

Sistemi SCADA/EMS (Sistemi i Kontrollit dhe Grumbullimit të të Dhënave/Sistemi i Menaxhimit të Energjisë) shërben për operimin e sistemit energjetik. Ky sistemi përveç se është një zgjidhje efikase për operimin e sistemit është gjithashtu një sistem informatik i cili i siguron OST-së, si vendimmarrës në lidhje me funksionimin e sistemit të transmetimit, informacione të besueshme mbi proceset, duke u mundësuar kështu operatorëve të menaxhojnë sistemin e energjisë në një mënyrë optimale. Platforma e tij e hapur dhe e gjithanshme lejon integrim të lehtë të sistemeve të tjera informative të shërbimeve duke ruajtur nivele të larta të sigurisë së IT. Aplikacionet e sistemit SCADA/EMS mund të përshtaten për kontroll dhe analizë në kohë reale si dhe për qëllime optimizimi dhe planifikimi. Në Sistemin kryesor SCADA të OST monitorohen në kohë reale të gjitha të dhënat që operohen nga n/stacionet 220/400 kV dhe n/stacionet më të rëndësishme 110 kV. Stacioni kryesor i Sistemit SCADA/EMS është instaluar në ambientet e QDK, OST. Për të garantuar nivelin më të lartë të disponueshmërisë dhe besueshmërisë, sistemi është plotësisht redundant në drejtim të infrastrukturës Hardware dhe Software.

Sistemi Emergjent i Kontrollit (ECC)

Sistemi ECC operon në konsistencë me Qendrën ekzistuese Kombëtare të Kontrollit (QDK), e implementuar në një nga nënstacionet e OST. Implementimi i një sistemi Emergjent Kontrolli ka ardhur si pasojë e zbatimit të direktivave të ENTSO-E mbi garantimin e vazhdueshmërisë së proceseve për OST-në, e cila duhet të ketë në dispozicion në çdo kohë dhe pa ndërprerje vëzhgueshmërinë e Rrjetit të Transmetimit edhe në rastet e dështimit të sistemit kryesor për arsye të ndryshme. Sistemi ECC punon në mënyrë të pavarur nga sistemi SCADA/EMS i QDS, por përdor të njëjtat burime të të dhënave dhe të njëjtin rrjet telekomunikacioni.

Electronic Highway

OST, në zbatim të direktivave kryerose të ENTSO-E, ka implementuar edhe nyjen e komunikimit për realizimin e shërbimeve të cilat shfrytëzojnë rrjetin e Electronic Highway. OST është pjesë zyrtare e Electronic Highway. Kjo nyje ndodhet në Qendrën Kombëtare të Kontrollit, në objektet e OST. Për garantimin e nivelit më të lartë të besueshmërisë dhe disponueshmërisë, sistemi është plotësisht redundant në infrastrukturë. Në kuadër të këtij projekti, OST shkëmben të dhëna në kohë reale me IPTO, CGES, ENTSO-E, nëpërmjet një rrjeti të dedikuar e të sigurtë, sipas të gjithë rekomandimeve të ENTSO-E. OST ka implementuar edhe shërbimet e tjera të kërkuara nga ENTSO-E për të cilat EH është vetëm mjet transmetues i tillë si sistemi EAS.

ENTSO-E Awareness System (EAS)

EAS është një platformë e centralizuar e cila ju lejon Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të shkëmbejnë të dhëna në kohë reale. EAS është një platformë informuese e cila ju pasqyron OST-ve partnere një pamje globale dhe në kohë reale të rrjetit europian të transmetimit. Operimi i kësaj platforme është shumë i dobishëm në rastet e një avarie apo situatë kritike në rrjet, pasi informacioni i paraqitur ju jep mundësinë operatorëve për të identifikuar origjinën e problemit, për të realizuar një vlerësim më të mirë të kushteve dhe arsyeve që dërguan në këtë situatë dhe mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemit. Përveç dërgimit në mënyrë automatike të të dhënave kryesore të sistemit tonë, operatorët raportojnë çdo ngjarje e cila ndikon në ndryshimin e gjëndjes së sistemit duke ndryshuar treguesin e gjëndjes së sistemit dhe duke paqsyruar arsyen e ndryshimit të gjëndjes së sistemit. Çdo operim në këtë sistem realizohet bazuar në dokumentin e Kodit të Rrjetit (si Udhëzues i Operimit të Sistemit).

Sistemet Lokale SCADA

Sistemet SCADA lokale shërbejnë si nyje periferike për marrjen e të dhënave dhe transmetimit të tyre drejt qendrave të kontrollit si dhe për automatizimin e proceseve që kryhen nëpër n/ST në pronësi të OST-së. Të dhënat ndërmjet sistemeve SCADA/EMS, SCADA/ECC dhe nyjeve periferike transmetohen duke përdorur një protokoll të caktuar duke shfrytëzuar rrjetin e Telekomunikacionit të OST sh.a. Këto sisteme ndërveprojnë me të dy qendra të kontrollit në distance në të njëjtën kohë. Sistemet lokale SCADA janë plotësisht redundant. Për të siguruar funksionimin normal të sistemit edhe në rastet kur një nga elementet dështon, këto sisteme sigurojnë mbështetje në nivel serverash dhe posteve të punës Scada për operatorët.

Platforma e Operimit të Tregut

OST është e detyruar të sigurojë transmetim të sigurt dhe të besueshëm të energjisë, kontroll efikas të sistemit energjetik të ndërlidhur me sistemet e energjisë të vendeve të tjera, zhvillim optimal dhe të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit që synon përmbushjen e nevojave të klientëve dhe të gjithë shoqërisë, sigurimin e funksionimit dhe zhvillimit të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike si dhe integrimin e tij në tregun rajonal dhe evropian të brendshëm të energjisë elektrike.

Për të përmbushur të gjitha kërkesat e sipërpërmendura, nga muaji Dhjetor 2023, OST ka implementuar Platformën NOVITA. Kjo platformë ofron zgjidhje të automatizuara për të trajtuar proceset që OST duhet të përmbushë në mënyrë që të jetë në pajtim me standardet. Platforma NOVITA është e organizuar në trajtë modulare, ku modulet janë të ndërlidhur mes tyre dhe kryejnë këto funksione:

- Alokimi i kapacitetit nderkufitar;
- Accounting dhe Settlement duke kryer përlogaritjen e flukseve në pikat e interkonjeksionit të cilat vijnë nga sistemi i matjes online;
- Skedulimi nderkufitar duke analizuar zonën ku do të veprojnë çdo partner si dhe marrjen e informacionit për procesin e Day-Ahead apo Intraday, si dhe Skedulimi i brendshëm.
- Mekanizmi i balancimit;
- Ankandin e Sherbimeve Ndihmëse;
- Menaxhimi i të llogaritjeve të disbalancave të paleve të tregut;
- Komunikimi me platformen e transparencës së ENTSO-E;
- Komunikimi me platformen e ALPEX.

Platforma e Sistemit të Matjes

Platforma e sistemit të matjes është e përbërë nga platforma kryesore e menaxhimit të energjisë elektrike dhe nga platforma mbështetëse (Backup). Të dy platformat janë në lidhje paralele funksionimi.

Sistemi i komunikimit ndërmjet platformave dhe pikave të matjes (matesit kryesor dhe kontrollues) realizohet nëpërmjet rrjetit GSM të ofruara nga Vodafone Albania dhe Telekom Albania, rrjetit GPRS të ofruara nga kompanitë celulare ALBtelekom dhe Telekom Albania duke përdorur komunikimin IPsec VPN dhe TCP nëpërmjet OPGW të Rrjetit të Telekomunikacionit të OST.

Për të garantuar nivelin më të lartë të disponueshmërisë dhe besueshmërisë, sistemi është i mbyllur nga rrjeti i jashtëm dhe i lejueshëm vetëm nga adresa IP të dedikuara. Gjithashtu është i ndërtuar me mbrojtje nga Firewall dhe Antivirus të licensuar dhe rinovuara sipas afateve në kohë.

Platforma e sistemit të matjes është në komunikim të dedikuar me platformën e menaxhimit të Operatorit të Tregut "NOVITA". Platforma e sistemit të matjes transmeton të dhëna nëpërmjet protokollit FTP në format CVS ose xml, ose nëpërmjet ndërfaqes Web për marrjen e të dhënave nga operatori i tregut. Nëpërmjet këtij procesi realizohet leximi dhe dërgimi automatik i të dhënave të energjisë elektrike nga linjat e interkonjeksionit në platformën e ENTSO-E.

Platforma e sistemit të matjes mundeson komunikim me sistemet SCADA dhe MiniSCADA me ndërfaqen e Portës së të Dhënave SCADA.

Gjenerimi i të dhënave të platformës së Menaxhimit të Energjisë Elektrike realizohet nëpërmjet ndërfaqes Web e cila lejon dhe kufizon aksesin bazuar në adresat IP si nga brenda ashtu dhe nga jashtë rrjetit.

Aksesimi i të dhënave në ndërfaqen Web është i menaxhueshëm nga Administratori i rrjetit sipas kërkesave të përdoruesve të brendshëm të OST të autorizuar më parë.

Sistemi Oracle EBS

Ky sistem përdoret për përpunimin e të gjitha të dhënave financiare të OST sh.a. duke menaxhuar në këtë mënyrë faturat dhe pagesat. Sistemi në fjalë gjithashtu është i integruar me sistemin e burimeve njerëzore i cili shërben për menaxhimin e punonjësve të kompanisë. Në këtë sistem gjithashtu ruhet dhe dokumentacioni i OST në mënyrë elektronike.

Sistemi PSSE

Ky sistem përdoret për krijimin e modeleve të rrjetit sipas formateve të kërkuara nga ENTSO-E.

Sistemi ODMS

Ky sistem është krijuar nga ENTSO-E dhe shërben për shkëmbimin e modeleve të rrjetit midis TSO-ve pjesë e saj. OST sh.a. i kalon modelet e rrjetit në sistemin ODMS dhe më pas i dërgon drejt ENTSO-E.

Sistemi Antivirusit Check Point

Ky sistem antivirusi është i instaluar në çdo kompjuter apo server të OST sh.a. dhe kryen mbrojtjen e pajisjeve elektronike nga viruse të ndryshëm. Ky sistem është i pajisur me një sistem monitorimi qendror në mënyrë që të mundësojë menaxhimin më të thjeshtë të kompjuterëve si dhe të rrjetit.

Sistemi WebProxy

Ky sistem monitoron të gjithë trafikun e internetit të krijuar nga përdoruesit apo pajisjet e OST sh.a. dhe kryen bllokimin e faqeve të padëshiruara apo të faqeve që përmbajnë viruse. Ky sistem është i pajisur me një sistem monitorimi qendror në mënyrë që të mundësojë menaxhimin më të thjeshtë të kompjuterëve si dhe të rrjetit.

Sistemi i mbrojtjes së email-eve

Ky sistem monitoron gjithë trafikun e email-eve që vijnë drejt OST sh.a. duke i analizuar ata dhe duke bërë kategorizimin e tyre. Ky sistem krye mbrojtjen e përdoruesve të email-it nga email-e të tipit SPAM.

OPDE (Operational Planning Data environment)

OPDE është një platforme në të cilën përcaktohen kërkesat minimale të Planifikimit Operativ me qëllim sigurimin e proceseve koherente dhe të koordinuara të planifikimit operativ të Zonave të Sinkronizuara të zbatueshme për të gjithë përdoruesit e rrjetit me rëndësi specifike si dhe të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Protokollet dhe certifikatat për standartet e sigurisë ofrohen nga ENTSO-E dhe konfigurohen nga administratorët e sistemit në server të veçantë në ambientet e OST.

SharePoint

SharePoint është një platformë aplikative në web, e përqendruar dhe e mbrojtur, që i ofron shoqërisë mbështetje për menaxhimin e të dhënave, përmbajtjeve dhe dokumentave në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt, duke përmirësuar procesin e punës. Microsoft SharePoint lejon krijimin e website-eve si dhe menaxhimin e portaleve intranet dhe extranet. Sigurinë e huazon drejtpërdrejt nga Active Directory, për sa i përket autentifikimit të userave.

Sistemi JPuna

është një sistem i cili kryen këto funksione:

- Kontrolli dhe monitorimi i punëve në terren
- Administrimi i remonteve
- Evidentimi i Defekteve
- Evidentimi i Aseteve
- Rregjister dhe historik i defekteve
- Njoftim stafi për remonte të planifikuara
- Menaxhimi i burimeve njerezore dhe Vleresim efektiv të punonjësve në njësitë operative.
- Aksesimi i Sistemit Jpuna realizohet si në rrjetin e OST dhe jashtë saj.

Phasor Measuring Unit - Wide Area Monitoring System

OST gjate vitit 2019, krahas sistemeve teknologjike ekzistuese ne operim, ka implementuar sistemin e Analizimit të Rrjetit nëpërmjet PMU-WAMS (Phasor Measuring Unit - Wide Area Monitoring System). WAMS është një sistem i përbërë nga disa elementë të cilat monitorojnë parametra të ndryshëm të sistemit elektroenergjetik, në kohë reale. Sistemi WAMS është në shfrytëzim vetëm për OST, duke mos ofruar të dhëna në mënyrë direkte për palët e treta.

Të dhënat e siguruar në një qendër kontrolli nga një rrjet WAMS janë të ngjashme me të dhënat e siguruar nga SCADA. Disponueshmëria dhe integriteti i të dhënave janë objektivat kryesore të sigurisë. Matja e tensionit dhe rrymave me njësi matëse fazorësh (PMU) japin mundësi të reja në përpunimin e të dhënave dhe rritjen e dinamikës së sistemit. Qëllimi kryesor i përdorimit është monitorimi i vazhdueshëm i parametrave dinamike të sistemit energjetik për dy role të përdoruesit: operatori i rrjetit dhe analisti i sistemit.

Software i Monitorimit të Sistemit (SIGUARD) merr të dhënat nga PMU-të të cilat janë instaluar në linjat e lartpërmendura dhe komunikon me programin SIGUARD nëpërmjet një sistemi të përshtatshëm të komunikimit.

Softweri WAMS ofron të gjitha funksionet si:

- Përqendrimi i të dhënave
- Ruajtja e të dhënave
- Rikthimin e të dhënave
- Përpunimin e të dhënave
- Analiza e të dhënave të transmetimit

➤ Shfaqja e të dhënave

4.2.2 Siguria e sistemeve të informacionit

Nga informacioni i siguruar pranë Drejtorisë së Sherbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtoria e Sherbimeve të Automatizuara të Rrjetit rezulton se janë marrë një sërë masash për të rritur sigurinë e informacionit dhe të sistemeve dhe konkretisht:

- Metodologjia e përdorur për të identifikuar dhe menaxhuar pikat e dobëta të sistemeve të informacionit

Metodologjia e përdorur për të identifikuar pikat e dobëta të sistemeve në shfrytëzim është duke monitoruar më mënyrë të vazhdueshme aktivitetet që përbëjnë risk. Këto aktivitete identifikohen në bazë të procedurave të standartizuara të riskut, identifikim i cili kryhet çdo 6-muaj. Në zbatim të rekomandimeve nga Drejtoria e Riskut, për çdo incident raportohet sipas procedurave më poshtë:

- PRO-RISK-001 Procedura e Raportimit të Ngjarjeve me Risk Operacional - V.1.0 signed;
- PRO/6.1, 8.2 & 8.3 Procedura për vlerësimin e rrezikut.

Për çdo incident të mundshëm realizohen analizat e nevojshme teknike, mbi të cilat merren masat e duhura.

- Software për të monitoruar dhe parandaluar rreziqet gjatë navigimit në internet, përdorimit të postës elektronike si dhe mbrojtjen e sistemeve nga viruset.
 - DSHTI, për t'i ofruar shërbim interneti të gjithë punonjësve të OST në mënyrë sa më të sigurt dhe cilësore, ka në përdorim një sistem *Internet Proxy* i cili monitoron dhe analizon të gjithë trafikun e internetit në OST. Ky sistem është i aftë të realizojë bllokimin automatik të faqeve të padëshiruara apo faqeve web të cilat përmbajnë viruse si dhe lajmërimin automatik të administratorit të sitemit lidhur me rreziqet e mundshme. Sistemi menaxhohet nga një konsolë qendrore monitorimi/menaxhimi nga ku bëhet raportimi i të gjithë aktivitetit të zhvilluar gjatë navigimit në internet nga çdo përdorues.
 - Sistemi i menaxhimit të postës elektronike *email* në OST menaxhohet në dy servera *microsoft exchange server 2016* të lidhur në cluster. Për të rritur parandalimin dhe monitorimin ndaj email-eve keqdashëse të gjitha email-et filtrohen nga një sistem i cili është i aftë të monitorojë, parandalojë dhe analizojë të gjitha email-et e dyshimta duke mos lejuar kalimin e tyre deri në përdoruesit e postës elektronike të OST.
 - Dhomat e Server-ave dhe ambientet teknologjike janë një komponent kritik i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në OST. Për të realizuar një monitorim të parametrave të temperaturës, lagështisë dhe prezencës së ujit në dhomat teknologjike ku janë të vendosura servera, gjatë vitit 2019 është implementuar një sistem monitorimi dhe lajmërimi nëse ka luhajtje të vlerave normale të kushteve ambientale brenda dhomave teknologjike.

- Rrjetat fizike të cilët shërbejnë për të transmetuar të dhëna shumë të rëndësishme sic janë të dhënat SCADA apo ato të matjes, janë tërësisht të ndara nga rrjeti LAN i përdoruesve të OST duke siguruar në këtë mënyrë një siguri të lartë fizike dhe softwerike të këtyre sistemeve;
- Sistemet SCADA nuk janë të ekspozuara në internet. Transmetimi i informacioneve nga nyjet periferike në drejtim të sistemeve SCADA realizohet nëpërmjet rrjetit të brendshëm të telekomunikacionit i cili është në pronësi të OST dhe përbëhet nga fibra optike. Profilët e përdoruesve janë të mirëpërcaktuar sipas roleve që duhet të kryejnë në system;
- Sistemi SCADA/EMS shfrytëzon software dhe pajisje firewall të certifikuar nga prodhuesit, nëpërmjet të cilave bëhet përditësimi i politikave të sigurisë, monitorim proaktiv të shkëmbimit të të dhënave në rrjetin SCADA si dhe marrje masa vlerësuese dhe parandaluese për rritjen e sigurisë të këtyre sistemeve. Gjithashtu përdoren dhe Software të licensuar të posacem të cilët kryejnë masa parandaluese dhe bllokuese mbi viruset e infiltuar në këto sisteme;
- Pajisjet e vecanta të përdorura nga sistemi SCADA janë Firewall të dedikuar dhe redundant ndërmejt njëri tjetrit, Servera të cilët autorizojnë aksesin në këto sisteme dhe antiviruse të licensuar.

Sa i përket masave të marra në kuadër hartimit të një plani masash/politikash sipas standardeve të BE dhe praktikave më të mira europiane që zbatohen në këtë fushë si dhe në zbatim të ligjit nr. 2/2017 “Mbi sigurinë kibernetike” dhe VKM nr. 553 datë 15.07.2020 “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit” (i ndryshuar) ku OST bën pjesë, për menaxhimin e situatave kritike si dhe çertifikimin e OST me ISO 27001 mbi Cyber Security, nga informacioni i marrë pranë Sektorit të Politikave të Sigurisë Kibernetike rezulton se:

Në përmbushje të detyrimeve të nenit 18 të Ligjit Nr.2/2017 “Mbi sigurinë kibernetike”, OST sh.a. ka bërë me dije për caktimin e pikës së kontaktit si dhe në përmbushje të detyrimeve të VKM nr. 553 datë 15.07.2020 (i ndryshuar), është bërë aprovimi si infrastrukturë kritike e informacionit me fokus platforma SCADA.

Gjatë vitit 2024 nuk rezulton të ketë patur incidente të sigurisë kibernetike.

Më konkretisht politika, Procedura dhe SOP (Standart Operation Procedures) të miratuara me qëllim përmbushjen e detyrimeve, janë të radhitura si më poshtë:

Lista e politikave:

| Nr. | Pika e Normës | Emri Procedurës |
|-----|-----------------------|---|
| 1. | POL/5.2 & A.5.1.1 | Politika për Sigurinë e Informacionit |
| 2. | POL/A.6.2 | Politika e Pajisjeve Elektronike |
| 3. | POL/A.6.2.1 | Politika për sigurinë e pajisjeve lëvizëse (mobile) |
| 4. | POL/A.6.2.1/1 | Politika për Laptopin |
| 5. | POL/A.6.2.2 | Politika e Teleworking |
| 6. | POL/ A.7 & A.7.2 | Politika për Internetin |
| 7. | POL/ A.7.1.1 & A.12.3 | Politika e Postacionit të Punës (Workstation) |
| 8. | POL/A.7.2.2 | Politika e Trajnimit për Rrjetin |
| 9. | POL/A.8.1.3 | Politika e përdorimit të pranueshëm të aseteve |

| | | |
|-----|----------------------|---|
| 10. | POL/A.8.2 | Politika për klasifikimin e informacionit të OST SH.A |
| 11. | POL/A.8.3 & A.11.2.7 | Politika e depozitimit dhe shkatërrimit |
| 12. | POL/A.9 | Politika për kontrollin e aksesit |
| 13. | POL/A.9.2 | Regjistrimi i përdoruesit menaxhimi i aksesit |
| 14. | POL/A.9.4 & A.11 | Politika për sigurinë e sistemeve informatike të OST |
| 15. | POL/A.9.4.3 | Politika e mbrojtjes së fjalëkalimit (Passwordeve) |
| 16. | POL/A.10 | Politika kriptografike |
| 17. | POL/A.11.1 | Politika e sigurisë së dhomës së Server-ave |
| 18. | POL/A.11.1.2 | Politika për Kartën e Hyrjes |
| 19. | POL/A.11.1.2/1 | Politika për Vizitorët |
| 20. | POL/A.11.2 | Politika e Infrastrukturës |
| 21. | POL/ A.11.2.9 | Politika Clear Desk dhe Clear Screen |
| 22. | POL/A.12.1.2 | Kontrolli i Ndryshimit |
| 23. | POL/A.12.3 | Politika për backup dhe rikuperim |
| 24. | POL/ A.12.5 | Politika Freeware dhe Shareware |
| 25. | POL/A.12.6 | Politika për Menaxhimin e Patch-ve |
| 26. | POL/A.13.1 | Politika për rrjetin (LAN-in) |
| 27. | POL/A.13.2.1 | Politika për transferimin e të dhënave nga punonjësit |
| 28. | POL/A.13.2.3 | Politika e postës elektronike |
| 29. | POL/A.13.2.4 | Politika e Konfidencialitetit dhe paanshmërisë |
| 30. | POL/A.15.1.1 | Politika e sigurisë për kontraktorët / konsulentët / furnitorët |
| 31. | POL/A.17.1 | Politika e vazhdimësisë së biznesit |
| 32. | POL/A.18.1.4 | Politika për mbrojtjen e të dhënave personale |
| 33. | POL-MB&SIG-SSAA-001 | Politikat e Mbrojtjes dhe Sigurisë së OST sh.a. |

Lista e procedurave

| Nr. | Pika Normës | Emri procedurës |
|-----|--------------------|--|
| 1 | PRO/4.1, 4.2 & 4.3 | Procedura Konteksti i Organizatës dhe fushëveprimit |
| 2 | PRO/4.4 | Procedura e Qasjes për Zbatimin e ISMS |
| 3 | PRO/5.3 | Procedura roli dhe përgjegjësia |
| 4 | PRO/6.1, 8.2 & 8.3 | Procedura për vlerësimin e rrezikut |
| 5 | PRO/6.1/1 | Procedura për deklaratën e zbatueshmërisë (SoA) |
| 6 | PRO/7.2 & 7.3 | Procedura e rekrutimit dhe trajnimit të personelit |
| 7 | PRO/7.3 | Procedura për masat disiplinore |
| 8 | PRO/7.4 | Procedura e komunikimeve të brendshme dhe të jashtme |
| 9 | PRO/7.5 | Procedura e menaxhimit të dokumenteve dhe regjistrimeve |
| 10 | PRO/9.1 & 10.2 | Procedura për matje, analiza dhe përmirësim |
| 11 | PRO/9.2 | Procedura e auditimit të brendshëm |
| 12 | PRO/9.3 | Procedura rishikimi i menaxhimit të drejtimit |
| 13 | PRO/10.1 | Procedura për masat korrigjuese dhe jokonformitetin |
| 14 | PRO/ A.6 | Procedura për Sigurinë e Organizatës |
| 15 | PRO/A 6.2 | Procedura për menaxhimin e mermorie-ve të lëvizshme |
| 16 | PRO/A 7.1 | Procedura për Planifikimin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit |
| 17 | PRO/A 7.2 | Procedura për Sigurinë e Personelit |
| 18 | PRO/A 8 | Procedura për Klasifikimin dhe Kontrollin e Aseteve |
| 19 | PRO/A 9 | Procedura për Kontrollin e Aksesit |
| 20 | PRO/A 11 | Procedura për sigurinë fizike dhe mjedisore |
| 21 | PRO/A 11.1.5 | Procedura e punës në mjedis të sigurt |
| 22 | PRO/A 12.1.2 | Procedura për planifikimin e ndryshimeve të procedurave dhe politikave |
| 23 | PRO/A 13 | Procedura për Komunikimet dhe Menaxhimin e Veprimtarive |
| 24 | PRO/A 13.2.4 | Procedura e Konfidencialitetit dhe paanshmërisë |
| 25 | PRO/A 15 | Procedura për vlerësimin e furnitorit |
| 26 | PRO/A 15.2 | Procedura për administrimin e blerjeve |
| 27 | PRO/A 16.1 | Procedura e Menaxhimit të Incidenteve |
| 28 | PRO/A 17.1/1 | Procedura për strategjinë e ruajtjes dhe rikthimit të të dhënave |
| 29 | PRO/A 17.1/2 | Procedura për planin e rimëkëmbjes nga katastrofat |
| 30 | PRO/A 18.1.1 | Procedura e identifikimit të ligjeve dhe kërkesave të tjera |
| 31 | PRO/01 | Procedura e OST SHA për COVID-19 |

Miratimi dhe hyrja në fuqi e këtyre politikave dhe procedurave u është komunikuar të gjithë stafit të OST nëpërmjet email-it zyrtar dhe për më tepër, këto dokumenta janë të publikuar edhe në Intranet-in e OST në rubrikën përkatëse “Politika dhe Procedura”.

Nga informacioni i marrë nga Sektori i Sigurisë së Informacionit rezulton se, gjatë vitit 2024 është kryer rinovimi i çertifikimit ISO 27001, ku OST sh.a. është riçertifikuar me ISO 27001:2022. Në bazë të këtij riçertifikimi, janë kryer ndryshimet dhe rishikimet e nevojshme në politikat dhe procedurat përkatëse, në përputhje me kërkesat e standardit ISO.

Në kuadër të riçertifikimit të OST me ISO 27001: 2022 mbi Cyber Security, gjatë vitit 2024, janë marrë ndërmarrë masat si vijon:

- a) Zgjerimi i Sistemit Antivirus: Sipas rekomandimeve nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike, është bërë zgjerimi i sistemit antivirus duke përfshirë Zgjerimin e Detektimit dhe Përgjigjes (XDR) dhe të Parandalimit dhe Përgjigjes së Zgjeruar (XPR), të cilat tejkalojnë masat e sigurisë tradicionale. Kjo nismë lindi nga nevoja për të mbrojtur sistemet kritike me një ndryshim drejt një qasjeje të integruar, inteligjente dhe parashikuese ndaj sigurisë kibernetike.
- b) Ristrukturimi i Infrastrukturës: Për të rritur sigurinë e informacionit dhe për të mbrojtur sistemet nga sulmet kibernetike, duke minimizuar rrezikun, është bërë një ristrukturim të infrastrukturës teknologjike të platformës së matjes së energjisë dhe të sistemeve SCADA/EMS, si dhe të sistemeve të IT-së.
- c) Segmentimi i Rrjetit dhe Përmirësimi i Firewall-it: është bërë segmentimi i domain-eve të Matjes, IT dhe SCADA duke implementuar dhe zëvendësuar firewall-e që ishin në fund të jetës së tyre me dy firewall-e të reja të gjeneratës së ardhshme Fortigate të cilat janë të konfiguruar si një klaster në rolet aktive/pasive.
- a) Siguria dhe Segmentimi i Rrjetit: Për të rritur sigurinë e komunikimit midis sistemeve, është realizuar segmentimi i rrjetit, dy firewall-e të gjeneratës së fundit model Cisco FTD 1120 janë konfiguruar në një klaster ku të gjitha lidhjet VPN për infrastrukturën e IT-së dhe për platformën e matjes përfundojnë në këto firewall-e. Gjithashtu trafiku i rrjetit, përfshirë menaxhimin ndaj kërcënimeve dhe ekspozimin në internet, menaxhohet përmes firewall-eve Cisco FTD të cilët suportojnë IDS/IPS *Intrusion detection systems/intrusion prevention systems*.
- b) Implementimi i Sistemeve të Rezervës: Për të siguruar një kopje rezervë të të gjithë infrastrukturës IT dhe platformës së matjes së energjisë, është implementuar një sistem backup në kasetë (tape) me kapacitet të mjaftueshëm për ruajtjen e të dhënave. Procesi i backup bëhet përmes sistemit Veeam backup sipas standardit 3-2-1-1-0.
- c) Në kuadër të rritjes së sigurisë në sistemet OT duke përfshirë infrastrukturën e sistemit SCADA/EMS dhe të gjitha nenstacionet e OST sh.a., është implementuar një projekt i financuar nga USAID/USEA, me objekt “*Just and Secure Energy Transition Program*”. Me anë të këtij sistemi realizohen funksionet e mëposhtme:
 - OT Zbulimi i Aseteve
 - OT Menaxhimi i Sigurisë së Aseteve

- OT Menaxhimi i ceneshmërisë
- OT Menaxhimi i Kërcënimeve
- OT Vlerësimi i Vektorit të Sulmit
- OT Baza e modelit të sigurisë
- OT Zbulimi dhe Monitorimi i Kërcënimeve të OT & Politikave.

Gjatë vitit 2024, OST ka bërë investime të konsiderueshme në infrastrukturën teknologjike për të rritur sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të informacionit, ku përmendim:

- a) Zgjerimi i Sistemit SCADA/EMS: Sipas rekomandimeve dhe standartave të sigurisë së informacionit është implementuar një site backup për sistemin SCADA/EMS me qëllim ruajtjen e informacionit në një vendodhje tjetër në distance gjeografike 100 km nga distanca e sistemit aktual.
- b) Përmirësimi i Infrastrukturës së Serverave: Tre serverë të fundit model HPE ProLiant DL380 Gen11 janë instaluar për të mbështetur virtualizimin dhe kalimin e pandërprerë të aplikacioneve në raste emergjence. Kjo infrastrukturë mbështetet nga licencat e VMWARE VSPHERE STANDARD 8 dhe lidhet me switch-e Fibre Channel dhe FlexNetwork për performancë të lartë dhe siguri të rrjetit.
- c) Zgjerimi i Sistemeve të Sigurisë së Informacionit: Implementimi dhe zgjerimi i masave të sigurisë si MFA, ZTNA dhe SIEM, duke përfshirë aksesin e kontrolluar të përdoruesve dhe menaxhimin e aktivitetit të tyre në kohë reale. Sistemi i privilegjuar i aksesit remote nga *BeyondTrust* dhe përditësimi i FortiSIEM janë pjesë kyçe të kësaj strategjie.
- d) Përmirësim i sistemit të kontroll monitorimit në Nënstacionet 220kV

Në respektim të rekomandimeve të lëna nga Autoriteti Kombëtar i Sigurisë Kibernetike gjatë vitit 2024 është realizuar përditësimi në versionet më të fundit të sistemeve të cilat e kishin kaluar ciklin e jetës së tyre (*end of life*) në versionet më të fundit për infrastrukturën kritike të informacionit OT në nënstacionet 220kV: Tirana 1, Elbasan 1, Babice dhe Burrel.

Gjithashtu, OST ka vijuar të trajtojë dhe ndërgjegjësojë stafin mbi rëndësinë e sigurisë së informacionit, duke krijuar një kulturë të fortë të mbrojtjes kibernetike. Përmes këtyre masave, OST mbetet e angazhuar për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për operacionet e saj, duke garantuar që infrastruktura e transmetimit të energjisë elektrike të mbetet e mbrojtur dhe funksionale përballë sfidave të vazhdueshme të sigurisë.

4.2.3 Të dhënat e platformave

Platformat elektronike të menaxhuara nga OST përmbajnë të dhëna teknike dhe financiare mbi aktivitetin e OST të cilat hidhen nga punonjës të OST që kanë të drejta aksesit dhe disa prej të cilave aksesohen nga përdoruesit e sistemit të transmetimit.

4.2.3.1 Të dhënat që hidhen nga përdoruesit e sistemeve

Sistemi SCADA mbledh në kohë reale dhe përpunon të dhënat e sistemit elektroenergjitik (të tilla si: fuqia active, reactive, rrymë, tension, frekuence, $\cos \varphi$, pozicion ancafkash, pozicionet e elementeve komutuese, alarme mbi gjendjen e sistemit etj) për qëllime monitorimi dhe

analizash, me fokus kryesor në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik, marrjes së masave në kohë dhe me efikasitet për parandalimin e avarive dhe minimizimin e kontigjencave. Ato kryejnë gjithashtu kontroll (komandim në distancë) të elementeve të sistemit elektroenergjetik, analiza të sistemit të transmetimit në kohë reale si dhe parashikimin e kongjestionëve në rrjet në rrafshet kohore të ndryshme.

Platforma NOVITA, ndërfaqëson me një sërë platformash e sistemesh të tilla si:

- Sistemi i matjeve të OST (QME);
- Platforma e Transparencës së ENTSO-E;
- Zyren e alokimit të kapaciteteve për Europën Juglindore (SEE CAO);
- Qendrën e koordinimit të shkëmbimeve ndërkufitare (Verification Platform);

Të dhënat që ngarkohen në këtë platformë kryhen nga përdoruesit e kesaj platforme të cilët janë punonjës të OST ose pjesëmarrës të regjistruar në tregjet e energjisë dhe këto të dhëna lidhen me proceset specifike të cilat zhvillohen nga ky sistem dhe në varësi të rolit që kanë përdoruesit.

4.2.3.2 Informacioni që palët e treta marrin nëpërmjet platformave

Platforma NOVITA - pjesëmarrësit e tregut, kanë një qasje të kufizuar vetëm në të dhënat dhe proceset e biznesit që lidhen me rolet të cilat luajnë ata në tregun e energjisë. Këta pjesëmarrës kanë të drejta vetëm në oraret e proceseve dhe ofertat e tyre. Në funksion të proceseve dhe kohës së zhvillimit të tyre, pjesëmarrësit zhvillojnë aktivitetet e tyre. Të dhënat të cilat shkëmbehen janë mirëpërcaktuar, dakortësuar ndërmjet palëve duke bërë të mundur garantimin maksimal të sigurisë të informacionit për të dhënat sensitive të karakterit tregtar.

Sistemi SCADA - palët e treta të cilat kanë akses në sistemin SCADA janë kontraktorët të cilët kanë nënshkruar një kontratë mirembajtjeje me OST për dhënie suporti mbi këto sisteme. Aksesit i këtyre kontraktorëve zhvillohet mbi baze të një kanali komunikimi të enkriptuar dhe të dedikuar për përdoruesin e autorizuar kontraktualisht, në mënyrë që çdo veprim, ndërhyrje ose akses të dhënash është i monitorueshëm nga specialistët e sektorit SCADA.

Sistemi i matjes online - Nga ky sistem nxirren dhe përgatiten raportet ditore dhe mujore të energjisë që dërgohen brenda njësisive të autorizuara më parë të OST.

Raportet ditore përfshijnë:

- Të dhënat orare të të gjitha pikave të matje, Ekport Aktiv dhe Import Aktiv;
- Të dhënat orare të të gjitha pikave të OSHEE-së, Eksport Aktiv dhe Import Aktiv;
- Të dhënat orare të të gjitha pikave të Konsumatorëve të Tregut të Liberalizuar të Energjisë në nivel 35 kV (të integruara përkohësisht në platformën e sistemit të matjes së energjisë në OST sh.a. deri në vendosjen në funksion të platformës së re të dedikuar për këtë proces)
- Të dhënat orare të Humbjeve në Sistem.

Raportet mujore përfshijnë:

- Të dhënat orare të të mërkurës së tretë të muajit dhe të dielës para saj, për të gjitha pikat e matjes (Ekport, Import, Aktiv, Reaktiv, Nivel Tensionit);

- Bilancin e energjisë mujore;
- Përgatitjen e Akt-Rakordimit ndërmjet OSHEE-së dhe OST sh.a.;
- Përgatitjen e Akt-Rakordimit ndërmjet KESH dhe OST sh.a.;
- Bilancin dhe Shkëmbimin e Energjisë në Linjat e Interkonjeksionit.

OST, në zbatim të Rregulloreve EC nr.714/2009 dhe nr.543/2013 (Rregullorja e Transparencës) mbi publikimin e të dhënave relevante të energjisë në platformën e transparencës, ka filluar procesin e dërgimit të të dhënave në këtë platformë në mënyrë të automatizuar, duke shfrytëzuar si burim informacioni të dhënat që gjeneron platforma NOVITA, sipas standarteve të mirëpërcaktuara nga ENTSO-E. Të dhënat që OST aktualisht i mundëson ENSTO-E janë si më poshtë:

- Kapaciteti total i instaluar i njesive të prodhimit mbi 100 MW.
- Parashikim i gjenerimit dhe ngarkesës së vendit.
- Skedulimi ndërkufitar orar.
- Alokimi eksplisit.
- Çmimi i disbalancave.
- Pamjaftueshmëria e aseteve të transmetimit etj.

Nga informacioni i marrë dhe monitorimi i kryer rezultojnë se sistemet e teknologjisë së informacionit dhe rrjeti i brendshëm i OST mbrohen në mënyrë efektive nga kërcënimet e viruseve nëpërmjet programeve të veçanta.

Gjithashtu, rezultojnë se strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tyre përdorin metodologji të avancuara për të identifikuar dhe menaxhuar pikat e dobëta të këtyre sistemeve.

Siguria e sistemeve, për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit të menaxhuar nga këto sisteme, arrihet duke përdorur teknologji të avancuara dhe duke aplikuar praktikën më të mirë, sipas shpjegimeve të bëra në pikën 4.2.2 më lart.

4.3 Pavarësia e shoqërisë

4.3.1 Çertifikimi i OST si operator i pavarur i transmetimit

OST sh.a. është çertifikuar nga ERE me Vendimin nr.43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.” duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në nenin 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 të Direktivës 72/2009 EC, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhënë në “Opinionin 1/17 në bazë të nenit 3(1) të Rregullores EC nr.714/2009 dhe nenit 10(6) të Direktives 2009/72/EC – Shqipëria – Çertifikimi i OST”, datë 23.01.2017.

Çertifikimi i OST nga ERE si Operator i pavarur i transmetimit të energjisë është bërë duke kërkuar nga OST dhënia e garancive shtesë në lidhje me:

- Pavarësinë e audituesit financiar;
- Mostransferimi i stafit;
- Ndarja e Operatorit të Tregut;
- Bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë;

- Programi i Pajtueshmërisë dhe Zyrtari i Pajtueshmërisë.

Përmbushja e ketyre kushteve siguron pavarësinë e OST nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror dhe në të njëjtën kohë shmang sjelljet diskriminuese ndaj përdoruesve të rrjetit të transmetimit.

Përmbushja e kushteve mbi pavarësinë e audituesit financiar, mostransferimit të stafit dhe programit të zyrtarit të pajtueshmërisë, janë trajtuar në këtë raport respektivisht në pikat 4.3.3.2, 4.3.2.4 dhe pika 1 (Hyrje).

- Sa i përket ndarjes së Operatorit të Tregut dhe krijimit të Bursës së Energjisë:

Në zbatim të nenit 57 të Ligjit nr 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” (i ndryshuar), VKM nr. 322 datë 15.05.2019 “Për krijimin dhe përcaktimin e formës ligjore dhe të strukturës së pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut” dhe të VKM nr. 609 datë 11.09.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e operatorit të tregut”, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me urdhrin e tyre të përbashkët, Nr. 10313/2 Prot., datë 14.01.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut”, ngritën Komisionin e Posaçëm i cili ndoqi dhe përmbylli procedurat e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut, si dhe hartoi për këtë qëllim raportin e tij perfundimtar. Ky raport u miratua me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë të MIE dhe MFE nr. 228 datë 28.07.2020. Në zbatim të këtij Urdhri dhe Njoftimit nr. 5727/2 datë 30.07.2020 nga MIE, Operatori i Sistemit të Transmetimit - OST sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut sh.a. – KOSTT sh.a., zhvilluan negociatat për ndarjen e aksioneve që do të nënshkruheshin nga secila prej palëve për të marrë pjesë si aksionarë në shoqërinë e Operatorit të Tregut – Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike si dhe Statutin dhe Marrëveshjen e Aksionarëve të kësaj shoqërie.

Me Vendimin nr. 12 datë 08.09.2020, Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a., miratoi pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Me Vendimin nr. 130, datë 05.10.2020, Asambleja e Përgjithshme e OST sh.a. – Ministria e Financave dhe Ekonomisë, miratoi pjesëmarrjen e OST sh.a., si aksionare në Shoqërinë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., me 57.25% të kapitalit themeltar; si dhe Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të cilat do të nënshkruheshin nga OST sh.a. dhe KOSTT sh.a.

Në datën 05 Tetor 2020, përfaqësuesit ligjorë të OST sh.a. dhe KOSTT sh.a., firmosën Marrëveshjen e aksionarëve dhe Statutin e shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX.

Shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a.- ALPEX, është regjistruar tashmë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë (me NIPT M02223006B).

- Sa i përket kushtit të “Bashkëpunimit ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë”, OST ka mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me të gjithë institucionet përkatëse për të gjetur zgjidhjen më të mirë për përmbushjen e këtij kushti, por realizimi me sukses i tij i tejkalohte kompetencat e OST megjithë perpjekjet e vazhdueshme.

Në këto kushte, në bazë të kërkesave të OST, ERE me Vendim nr.58, datë 15.03.2018, Vendim nr. 47, datë 19.03.2019 si dhe Vendim nr. 207, date 16.12.2019 ka vendosur shtyrjen e afatit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr.43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, te Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 pika 6 të Direktivës 2009/72/EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjise”, deri më datë 16.06.2020.

Ndërkohë, me shkresë nr.1434 prot., datë 06.02.2020, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka njoftuar OST mbi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 836, datë 24.12.2019 “Për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar”.

Me anë të ligjit nr. 61/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, janë miratuar ndryshimet në nenin 31 pika 1 të Ligjit.

Me vendim nr. 99, date 24.06.2020, ERE ka vendosur shfuqizimin e pikave 2,3 dhe 4 te Vendimit te ERE-s nr.43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a” duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin e përcaktuar në nenin 54 dhe 58 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 të Direktivës 72/2009 EC, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke lënë detyrimin për OST të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.

4.3.2 Pavarësia e Menaxhimit

OST sh.a. është e organizuar dhe funksionon si shoqëri tregtare në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Statutit të shoqërisë si dhe akteve të brendshme të saj. Organet drejtuese të shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori që ushtrojnë kompetencat e tyre sipas përcaktimeve të ligjit të lartpërmendur dhe Statutit të Shoqërisë.

Në referim të nenit 135 pika (b) të Ligjit për shoqëritë tregtare ku percaktohet se “*Asambleja e Përgjithshme merr vendime për emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të administrimit (sistemi me një nivel) dhe (në sistemin me dy nivele) të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës*” si dhe nenit 13 te Statutit të OST ku përcaktohet se “*Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme*”, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme, ka emëruar anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të OST, duke respektuar parashikimet e pikës 3, të VKM-së nr.317, datë 27.4.2016, “Për përcaktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Shoqërive të Sektorit të Energjisë Elektrike” dhe parashikimet e nenit 54 te Ligjit 43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike”.

Gjithashtu, Administratori i shoqërisë është emëruar nga Këshilli mbikqyrës në bazë të nenit 158 të ligjit për shoqëritë tregtare ku përcaktohet se “Këshilli i administrimit emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, për një afat të përcaktuar në statut, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet”, si dhe nenit 20.1 të Statutit të OST sh.a. ku përcaktohet se “Këshilli Mbikqyrës emëron Administratorin e Shoqërisë”.

4.3.2.1 Këshilli Mbikqyrës

Deri në datë 31.12.2024, Këshilli Mbikqyrës përbëhej nga 5 anëtarë, si vijon:

- Znj. Vasilika Vjero (kryetar)
- Znj. Viola Haxhiademi (anëtar)
- Znj. Lira Pipa (anëtar)
- Z. Endrit Yzeiraj (anëtar)
- Z. Antonio Bushati (anëtar)

Gjatë periudhës 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Me Vendimin e Asamblesë së Aksionarit Nr.39, datë 25.06.2024 “Për ndryshime në Këshillin Mbikqyrës”, janë bërë ndryshime në përbërjen e Këshillit Mbikqyrës si vijon:

Liruar nga detyra:

- Znj. Merita Gurabardhi (anëtar)
- Z. Nikolla Lera (anëtar)
- Z. Klodian Mene (anëtar)

Emëruar në detyrë:

- Znj. Lira Pipa (anëtar)
- Z. Endrit Yzeiraj (anëtar)
- Znj. Kamela Banushi (anëtar)

Vendim me vendimin e Asamblese se Aksionarit Nr. 1167, datë 30.12.2024 “Për lirimin nga Këshilli Mbikqyrës” është liruar nga detyra:

- Znj. Kamela Banushi (anëtar)

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 135 pika “b” të Ligjit për shoqëritë tregtare si dhe pikës 3 të VKM-së nr. 317, datë 27.4.2016 “Për përcaktimin e Autoritetit Publik që Përfaqëson Shtetin si Pronar të Shoqërive të Sektorit të Energjisë Elektrike, është përcaktuar se: “Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, emërojnë anëtarët e këshillave mbikqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Duke marrë në konsideratë ndarjen II “Statusi ligjor dhe struktura e shoqërisë” pika 3 të Programit të Pajtueshmërisë, rezulton se emërimi i anëtarëve është bërë duke respektuar kufizimet e imponuara nga neni 54 i ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar.

4.3.2.2 Administratori

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, OST është drejtuar nga Administratori i emëruar me vendim nr. 3, datë 28.03.2022 të Këshillit Mbikqyrës me të cilin është lidhur kontrata për administrimin e shoqërisë ku parashikohen kushte për ushtrimin e funksionit duke shmangur konfliktin e interesit si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm tregtar, e cila është nënshkruar nga Administratori i shoqërisë.

Emërimi i Administratorit të shoqërisë është bërë në bazë të parashikimeve të nenit 158 të ligjit për shoqëritë tregtare si dhe në bazë të nenit 20.1. të Statutit të OST.

4.3.2.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

Për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 Këshilli Mbikqyrës ka zhvilluar 13 mbledhje në të cilat janë miratuar 14 vendime.

Zyrtari i pajtueshmërisë nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e zhvilluara.

Pjesëmarrja e zyrtarit të pajtueshmërisë në mbledhjet e organeve të shoqërisë sic është këshilli mbikqyrës është një e drejtë që buron nga kontrata për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë (pika 56 dhe 57) dhe është veçanërisht e detyrueshme ndjekja e mbledhjeve/takimeve të përcaktuara në pikën 3.1.8 të kontratës. OST ka detyrimin t'i ofrojë zyrtarit të pajtueshmërisë të gjitha kushtet për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër sipas kontratës (shih nenin 5 të kontratës – detyrimet e OST).

4.3.2.4 Drejtuesit e OST

Në referim të pikës B.1 të Programit të Pajtueshmërisë, drejtuesit e OST, të tillë si Kryetari dhe Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratori dhe stafi drejtues (drejtuesit e njërive strukturorë), duhet të jenë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre të përditshme. Ky detyrim përfshin dhe punonjësit të raportojnë direkt tek menaxhimi për çeshtje që kanë të bëjnë me operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit.

Programi i pajtueshmërisë përcakton disa kërkesa të cilat janë marrë në konsideratë nga zyrtari i pajtueshmërisë për të gjykuar në lidhje me pavarësinë e punonjësve që mbajnë poste drejtuese në OST, e konkretisht: punësimin/lidhjen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, përcaktimi i pagës për këta punonjës, interesi ose përfitimet financiare në mënyrë të drejtperdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, transferimi nga këto kompani dhe anasjelltas, zotërimi ose jo i aksioneve në këto kompani.

Në lidhje me këto kritere, është kërkuar informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të OST për personat e emëruar në poste drejtuese për vitin 2024, backgroundin e tyre profesional sipas CV-ve, librezën e tyre të punës si dhe kontratën individuale të punës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezulton se:

Është lidhur kontratë e re pune për 1 (një) punonjës në nivel drejtori dhe për 1 (një) punonjës në nivel shef sektori. Nuk rezulton që këta punonjës të kenë patur marrëdhënie

punë/interesi/përfitime financiare nga kompanitë shtetërore të prodhimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike.

Gjithashtu, janë bërë ndryshime pozicionesh duke kaluar në Shef Sektori 3 (tre) punonjës të brendshëm të OST.

Paga e tyre është përcaktuar në bazë të Udhëzimit dhe strukturës së pagave të OST miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës.

Nuk ka ndonjë informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për konflikt të mundshëm interesi për punonjësit aktualë apo atyre të punësuar rishtazi.

Mostransferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, është një nga kushtet e vendosura në Vendim të ERE nr.43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9 pika 6 të Direktivës 2009/72/EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”.

Në përmbushje të këtij detyrimi OST ka parashikuar në Kontratën Kolektive të punës një klauzolë ku përcaktohet se punonjësit që mbajnë pozicione “Drejtori” dhe raportojnë direkt tek Administratori i Shoqërisë dhe “Shef Sektori” të lidhur me aktivitetet e përditshme të shoqërisë, nuk do të punësohen tek ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, për një periudhë 1 vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies së punës me OST sh.a. dhe ka informuar ERE-n mbi këtë përcaktim, me anë të shkresës nr.2143 prot., datë 16.03.2018.

Në Dhjetor të vitit 2022 ka përfunduar afati i Kontratës Kolektive të Punës, por në zbatim të nenit 73 të saj, zbatimi i aplikimit të ndalimit të punësimit tek ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike i parashikuar në nenin 54 të saj, do të vazhdojë të jetë në fuqi deri në nënshkrimin e kontratës së re kolektive.

Kontrata individuale e punës e hartuar në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës si dhe akteve të brendshme të shoqërisë të detyrueshme për t’u zbatuar, përmban parashikime në lidhje me mënyrën e përdorimit dhe trajtimit të informacionit konfidencial nga punonjësit që janë në dijeni të tij për shkak të pozicionit që ato mbajnë, që është një nga kriteret e pavarësisë së punonjësve gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij kriteri, parashikimet e ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe të akteve të tjera në fuqi mbi trajtimin e informacionit konfidencial si dhe sekretit tregtar që punonjësit e OST vihen në dijeni për shkak të detyrës, të gjithë punonjësit në pozicione drejtuese në OST sipas kategorive të përcaktuara në Aneksin bashkëlidhur Kontratës Kolektive nr. 8336 prot., datë 16.12.2019, kanë nënshkruar marrëveshjen e konfidencialitetit. Këto ndryshime i janë bërë me dije ERE-s me anë të shkresës 3524/2, datë 10.06.2021.

Nga informacioni i marrë pranë DBNJ, rezulton se edhe punonjësit e rinj të punësuar gjatë vitit 2024 kanë nënshkruar marrëveshjen e konfidencialitetit.

4.3.3 Pavarësia financiare

Monitorimi i përbushjes së këtij detyrimi është bërë duke marrë parasysh programin ekonomik për vitin 2024 dhe miratimin e tij, pasqyrat financiare si dhe audituesit ligjorë të emëruar.

4.3.3.1 Programi ekonomik

Në lidhje me këtë kriter janë marrë në shqyrtim miratimi i programit ekonomik për vitin 2024 si dhe emërimi i audituesve ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se:

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. me Vendim Nr.17, datë 14.12.2023 ka miratuar programin e zhvillimit ekonomik të OST për vitin 2024, miratuar me shkresë nr. 716/1, datë 06.02.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në cilësinë e Aksionerit të Vetëm.

Për të hartuar Programin e Zhvillimit Ekonomik janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm⁷:

- Parashikimet afatmesme dhe afatgjata të investimeve, programimi i shpenzimeve operative të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit normal në funksion të një shërbimi sa më të plotë dhe cilësor dhe përdorimi me efikasitet i aseteve të shoqërisë;
- Kërkesat e Njësive Operative drejtuar OST-së;
- Realizimet ndër vite për secilin zë, realizimi faktik 9 mujor për vitin 2023 si dhe parashikimi për pritshmërinë e vitit 2023;
- Struktura organizative e OST sh.a.;
- Kërkesat që dalin nga aderimi i OST sh.a. në organizmat ndërkombëtare.

Gjatë vitit 2024, programi ekonomik është ndryshuar me Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës si vijon:

- Vendim nr. 4, datë 29.05.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 17, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2024”;
- Vendim nr. 8, datë 18.07.2024 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 17, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2024”. Ky ndryshim i planit financiar është miratuar me anë të shkresës nr. 10027/1 prot., datë 05.08.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në cilësinë e Aksionerit të Vetëm;
- Vendim nr.11, date 31.10.2024 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 17, datë 14.12.2023 “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2024”.

Këto ndryshime janë kryer me qëllim përshtatjen e programit ekonomik me kushtet aktuale e teknike të OST dhe kanë konsistuar konsistuar në rishikimin e tabelës së Projekteve të Investimeve me fondet e OST sh.a..

⁷ Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria Ekonomike, materialet shpjeguese dërguar Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e programit ekonomik për vitin 2024.

4.3.3.2 Pasqyrat financiare

Pasqyrat Financiare të OST përgatiten në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB.

Me vendim nr.1, date 18.04.2024 të Këshillit Mbikqyrës janë miratuar pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara të OST për vitin 2023.

Me vendim nr. 19, datë 16.05.2024 të Aksionarit të Vetëm, janë miratuar pasqyrat financiare të OST për vitin 2023 të çertifikuara nga Audituesit Ligjorë.

Me shkresën nr. 16509 Prot., datë 31.12.2024 të Aksionerit të Vetëm, janë caktuar Audituesit Ligjorë për kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm dhe çertifikimin e Pasqyrave Financiare të OST sh.a. për vitin 2024.

Më datë 28 Mars 2025 audituesit ligjorë kanë paraqitur raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Individuale të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024 ku kanë shprehur opinion pa rezerva mbi këto pasqyra.

Referuar opinionit të audituesve ligjorë, pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2024, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Aktualisht është në proces finalizimi auditimi i Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të shoqërisë, ndërkohë që vijon auditimi i pasqyrave financiare të projekteve në përputhje me kërkesat e raportimit të donatorëve.

4.3.3.3 Audituesit ligjorë

Me shkresë nr. 16509 Prot., datë 31.12.2024, Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka emëruar Audituesit Ligjorë për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore të OST për vitin 2024.

Në vijim, me qëllim garantimin e pavarësisë së audituesve ligjorë që është një nga kërkesat e vendimit të ERE-s për çertifikimin e OST si operator i pavarur, me anë të shkresës nr. 1673 prot., datë 17.03.2025, OST i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e përfaqësuesit të aksionarit të vetëm për shoqëritë KESH dhe OSHEE duke e informuar mbi audituesit ligjorë të caktuar për auditimin e pasqyrave financiare të OST për vitin 2024, me qëllim garantimin e pavarësisë së audituesve të emëruar për auditim në shoqëritë KESH dhe OSHEE.

Kontrata nr. 808 prot., datë 04.02.2025 "Për kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të Pasqyrave Financiare Individuale, Pasqyrave Financiare të Konsoliduara si dhe Pasqyrave të Projekteve të financuara me fonde të huaja, për vitin ushtrimor të mbyllur më 31.12.2024 të shoqërisë OST sh.a.", lidhur ndërmjet OST dhe audituesve ligjorë, përmban klauzola mbi

konfidencialitetin e informacionit të mbledhur gjatë kryerjes së shërbimit nga ekspertët, si dhe përgjegjësinë për dëshmipërblim në rast të shkeljes së tyre.

4.3.4 Pavarësia operacionale

Pavarësia operacionale ka të bëjë me (i) burimet e duhura teknike, njerëzore apo të tjera të nevojshme për të operuar në mënyre eficiente dhe (ii) një seri kufizimesh në marrëdhëniet me kompanitë vertikalisht të integruara, të cilat sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, referuar kushteve të Programit të Pajtuëshmërisë.

Rezulton se stafi i OST nuk ka marrëdhënie punësimi me kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror ose degë të tyre.

Gjithashtu, OST siguron shërbime të suportit teknik nga palë të treta në bazë të kontratave të lidhura.

Nga verifikimi i këtyre kontratave rezulton se ato janë në pajtuëshmëri me kushtet e programit të pajtuëshmërisë (klauzolat e konfidencialitetit).

- Sa i përket ndarjes së ndonjë sistemi informacioni (në terma të hardware dhe software) me ndonjë nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror ose degë të tyre ose kontraktorë të tyre në lidhje me sistemet e tyre të sigurisë dhe të informacionit, pas marrjes së informacionit nga Departamenti i Operimit të Sistemit ka rezultuar se:

Përgjatë vitit 2024, nuk rezulton që OST të ketë ndarë ndonjë sistem informacioni nga pikëpamja Hardware. Në lidhje me pjesën Software, OST merr informacione nga disa sisteme SCADA të KESH dhe OSHEE për qëllime monitorimi të nënstacioneve si dhe në bazë të kërkesave që duhet të plotësojnë përdoruesit e lidhur në rrjetin e OST, referuar kodit të transmetimit.

Përsa më lart, shkëmbimi i informacionit bëhet në respektim të dispozitave të Kodit të Transmetimit në lidhje me konfidencialitetin e konkretisht: nenit 9 “Komunikimi ndërmjet OST dhe përdoruesve” dhe Neni 10 “Konfidencialiteti”.

Shpjegime të hollësishme mbi sigurinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar janë dhënë në pikën 4.2.1 të këtij Raporti.

KAPITULLI II

5. Zbatimi i rekomandimeve të zyrtarit të pajtuëshmërisë për një implementim sa më eficient të programit të pajtuëshmërisë

Kjo pjesë e raportit paraqet masa e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ZP në raportin e vitit 2023.

5.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

Si një detyrim që lind nga përcaktimet e Programit të Pajtuëshmërisë së OST dhe duke marrë parasysh faktin që gjatë vitit 2024 (periudha Nëntor-Dhjetor 2024) ZP nuk është njoftuar mbi

mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, rekomandoj që strukturat përkatëse të OST të njoftojnë zyrtarisht ZP për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit dhe veçanërisht ato të përcaktuara në pikat 56.1, 56.2 dhe 56.3 të programit të pajtueshmërisë që do të zhvillohen në vijim si dhe t'i vënë në dispozicion materialet e nevojshme të mbledhjeve.

Ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

5.2 Trajnimet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/sekretit tregtar

Në funksion të përmbushjes së parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë dhe përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë për ruajtjen e konfidencialitetit të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar, është e rëndësishme kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me të gjithë punonjësit e OST dhe veçanërisht me ato punonjës që kanë të drejta akses në platformat elektronike të OST.

Në lidhje me këtë pikë, nga Zyrtari i Pajtueshmërisë është rekomanduar hartimi dhe përgatitja e një programi trajnues nga Sektori i Politikave të Sigurisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve TI dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Automatizuara të Rrjetit, i cili të përmbajë tema të veçanta dhe të personalizuar sipas platformave në menaxhim dhe punonjësve që do të trajnohen. Nga verifikimi i kryer, rezultojnë se gjatë vitit 2024 është bërë asistim i vazhdueshëm i punonjësve të rinj nga punonjësit aktualë dhe me eksperiencë në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave/informacionit të ndjeshëm apo sekretit tregtar për punonjësit të cilët kanë akses në platformat që OST menaxhon, në respektim të politikave të sigurisë së informacionit dhe marrëveshjeve individuale të konfidencialitetit. Nga Sektori i Politikave të Sigurisë Kibernetike janë dërguar e-maile ndërgjegjësimi për stafin në Aparatin Qendror në kuadër të Sigurisë së Informacionit me qëllim rritjen e vëmendjes dhe ndërgjegjësimit për rëndësinë e Sigurisë Kibernetike.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

5.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron

Duke qenë se OST ka tashmë si objekt të veprimtarisë së saj zhvillimin dhe funksionimin në fushën e komunikimeve elektronike sikurse është vënia në dispozicion e rrjetit të fibrave optike (OPGW) në dispozicion të të tretëve, është rekomanduar që ZP të informohet vazhdimisht nga Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit mbi ecurinë e projektit si dhe t'i vihet në dispozicion paraprakisht draft-kontrata që do të lidhet me të tretët, në lidhje me kushtet që do të vendosen për sigurinë e sistemit të transmetimit si dhe sigurinë kibernetike.

Nga informacioni i marrë, trajtuar në pikën 4.1.2.1, rezultojnë që ky informacion i është vënë në dispozicion Zyrtarit të Pajtueshmërisë në momentin që është kërkuar për hartimin e këtij raporti.

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

5.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtueshmërisë

Duke marrë në konsideratë ndryshimet më të fundit në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore, si dhe të strukturës organizative të OST është rekomanduar që OST të bëjë rishikimin e Programit të Pajtueshmërisë, duke reflektuar në të ndryshimet e përmendura më lart.

Nga verifikimi i kryer rezulton që programi i pajtueshmerise nuk është rishikuar.

Përsa më lart, rezulton se ky rekomandim nuk është zbatuar.

6. Rekomandimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për një implementim sa më eficient të programit të pajtueshmërisë

Kjo pjesë e raportit paraqet procedurat e nevojshme që duhen ndjekur për të zhvilluar dhe implementuar një seri veprimesh të cilat do të aktivizojnë sensin e kulturës korporative për ndërgjegjësimin e stafit të shoqërisë mbi çështjet e pajtueshmërisë.

6.1 Njoftimi zyrtar dhe pjesëmarrja e ZP në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës

Si një detyrim që lind nga përcaktimet e Programit të Pajtueshmërisë së OST dhe duke marrë parasysh faktin që gjatë vitit 2023 ZP nuk është njoftuar mbi mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, rekomandoj që strukturat përkatëse të OST të njoftojnë zyrtarisht ZP për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit dhe veçanërisht ato të përcaktuara në pikat 56.1, 56.2 dhe 56.3 të programit të pajtueshmërisë që do të zhvillohen në vijim si dhe t'i vënë në dispozicion materialet e nevojshme të mbledhjeve.

6.2 Trajnimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar

Në funksion të përmbushjes së parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë dhe përcaktimeve të Programit të Pajtueshmerisë për ruajtjen e konfidencialitetit të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar, është e rëndësishme kryerja e trajnimeve të vazhdueshme me të gjithë punonjësit e OST dhe veçanërisht me ato punonjës që kanë të drejta aksesit në platformat elektronike të OST.

Në lidhje me këtë pikë, rekomandoj mbajtjen në fokus të veçantë nga Sektori i Politikave të Sigurisë së Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve TI dhe Drejtorinë e Shërbimeve të Automatizuara të Rrjetit, informimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve dhe veçanërisht të atyre të punësuar rishtazi për ruajtjen e konfidencialitetit të dhënave/informacionit të ndjeshëm tregtar.

6.3 Informimi i ZP mbi vënien në dispozicion të të tretëve të rrjetit të fibrave optive (OPGW) që OST zotëron

Duke qenë se OST do të vijojë me veprimtaritë e ardhshme në fushën e komunikimeve elektronike sikurse është vënia në dispozicion e rrjetit të fibrave optike (OPGW) në dispozicion të të tretëve, rekomandoj që ZP të vijojë të informohet vazhdimisht nga Drejtoria e Shërbimeve të Telekomunikacionit mbi ecurinë e projektit si dhe t'i vihet në dispozicion paraprakisht draft-kontrata që do të lidhet me të tretët, në lidhje me kushtet që do të vendosen për sigurinë e sistemit të transmetimit si dhe sigurinë kibernetike.

6.4 Rishikimi dhe përditësimi i Programit të Pajtuëshmërisë

Duke marrë në konsideratë ndryshimet më të fundit në aktet ligjore, nënligjore, rregullatore, si dhe të strukturës organizative të OST duhet bërë rishikimi i Programit të Pajtuëshmërisë me qëllim përshtatjen me ndryshimet më të fundit.

Përsa më lart, rekomandoj që OST të bëjë rishikimin e Programit të Pajtuëshmërisë, duke reflektuar në të ndryshimet më të fundit ligjore, nënligjore, rregullatore si dhe ndryshimet e strukturës organizative të OST.

KAPITULLI III

7. Konkluzione

Duke marrë në konsideratë sa është reflektuar në këtë raport për vitin 2024, në kuadër të angazhimeve të marra përsipër nga OST me certifikimin e tij si operator i pavarur i transmetimit të energjisë elektrike si dhe në përballje me sfidat që vijnë nga operimi i tregut të balancimit i cili ka mundur kalimin përfundimtar nga një mekanizëm i rregulluar me entitete publike, në një liberalizim të tregut të energjisë balancuese, ku çdo palë ofruese e shërbimeve të balancimit mund të marrë pjesë dhe të bëhet konkurrese me produktet e saj për shërbimet e balancimit, shoqëria ka bërë përpjekje dhe angazhohet vazhdimisht në përmbushjen e kushteve të pavarësisë së shoqërisë në drejtim të:

- (i) sigurimit të shërbimeve të nevojshme për balancimin e sistemit, në kohë reale bazuar në parimet e tregut të hapur, transparent dhe jodiskriminues për të gjitha palët ofruese të shërbimeve të balancimit; dhe
- (ii) trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit të transmetimit në drejtim të transparencës dhe aksesit të barabartë për të gjithë përdoruesit në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator që drejton sektorin e energjisë elektrike.

Gjithashtu, rezulton se shoqëria ka ruajtur më së miri pavarësinë e saj nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke marrë në konsideratë:

- i) pavarësinë e menaxhimit, në vlerësim të kriterëve që kanë të bëjnë me punësimin/lidhjen profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, përcaktimit të pagës për këta punonjës, interesit ose përfitimeve financiare në mënyrë të drejtperdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, transferimit nga këto kompani dhe anasjelltas, zotërimit ose jo i aksioneve në këto kompani si dhe zbatimit të klauzoles së ndalimit të punësimit tek ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike;
- ii) pavarësinë financiare, në vlerësim të hartimit të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("IASB") dhe interpretimeve të publikuara nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare ("IFRIC") të IASB; si dhe

- iii) pavarësinë operacionale, në vlerësim të veprimtarisë së kryer duke respektuar klauzolat e konfidencialitetit gjatë shkëmbimit të informacionit me kompanitë e prodhimit apo shpërndarjes apo palët e treta.

Raporti i vitit 2024 nuk nxjerr në pah ndonjë shkelje të qenësishme që të rezultojë në mosplotësim të ndonjë prej kërkesave të pajtuëshmërisë që do të cënonte (i) pavarësinë e OST nga kompanitë vertikalisht të integruara që kryejnë ose janë të angazhuara në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror (ii) konfidencialitetin e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar si dhe (iii) trajtimin e barabartë të përdoruesve të sistemit. Vlen të theksohet që janë për t'u vlerësuar përpjekjet e bëra dhe masat e marra në kuadër të sigurisë kibernetike dhe sigurisë së informacionit duke shmangur në këtë mënyrë incidente si për shërbimet e brendshme të sistemit ashtu dhe për shërbimet që operatorët e tjerë përfitojnë nëpërmjet rrjetit e të dhënave me fibër optike, duke ndikuar në këtë mënyrë në një operim të sigurt të sistemit.

Vijimi i një bashkëpunimi të ngushtë dhe të vazhdueshëm i organeve drejtuese si dhe i stafit të shoqërisë me Zyrtarin e Pajtuëshmërisë, është një domosdoshmëri për përmbushjen e plotë, brenda afateve të përcaktuara si dhe në cilësinë e duhur, të detyrimeve që burojnë nga kontrata për ofrimin e shërbimeve të ZP, me qëllim identifikimin dhe shmangien e rasteve të sjelljeve diskriminuëse ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit dhe ofruesve të shërbimeve të balancimit, ruajtjen e të dhënave dhe të informacionit të ndjeshëm tregtar si dhe pavarësinë e stafit drejtues dhe punonjësve të tjerë të shoqërisë në shmangien e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës së tyre.

Ndërgjegjësimi i stafit të shoqërisë mbi programin e pajtuëshmërisë si dhe respektimi i detyrimeve të përcaktuara në të, të monitoruara prej Zyrtarit të Pajtuëshmërisë ndihmon në krijimin e një kulture korporative mbi çështjet e pajtuëshmërisë.

Në përfundim, përfshirja e Zyrtarit të Pajtuëshmërisë, brenda kuadrit të detyrave të ngarkuara nga programi i pajtuëshmërisë dhe kontrata e ZP si dhe informimi i vazhdueshëm i tij nga strukturat përkatëse mbi çdo problematikë të shfaqur dhe që cënon shtyllat kryesore që sigurojnë parimet themelore të veprimtarisë së OST, konsiderohet një hap i rëndësishëm për mbikqyrjen dhe garantimin e respektimit të këtyre parimeve.

Tiranë më 29.04.2025

Brunilda Veizi

Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST sh.a.



Vlerësimi i Raportit Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2024

Enti Rregullator i Energjisë (ERE), në cilësinë e autoritetit rregullator të pavarur për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri, ka një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionimit të drejtë, transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë elektrike. Një nga mekanizmat kyç të këtij funksioni mbikëqyrës është analiza dhe vlerësimi i raportit vjetor të pajtueshmërisë, i hartuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë të operatorëve të sistemit të energjisë elektrike. Qëllimi i analizës së raportit vjetor të pajtueshmërisë është të sigurojë se shoqëria po respekton në praktikë ndarjen e funksioneve, mbron informacionin konfidencial dhe nuk favorizon palë të treta të lidhura në mënyrë të padrejtë, etj.

Kjo detyrë e ERE-s mbështetet në nenin 54 “Ndarja e pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit” dhe 58 “Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përcakton parimin e ndarjes ligjore, funksionale dhe organizative të operatorëve të sistemit të shpërndarjes dhe transmetimit që operojnë në sektorin e energjisë elektrike dhe që janë pjesë e një grupi të integruar vertikalisht, në Vendimin të Bordit të ERE nr. 103, datë 30.04.2018 ku përcaktohen detyrimet e OST sh.a. për zbatimin dhe monitorimin e Programit të Pajtueshmërisë, si dhe roli i Zyrtarit të Pajtueshmërisë në raportim dhe mbikëqyrje. Vendimet nr. 194/2019 dhe nr. 252/2024 përcaktojnë obligimet e OST sh.a. për raportimin mbi përdorimin e rrjetit OPGW dhe kryerjen e detyrave të Zyrtarit të Pajtueshmërisë deri në miratimin e emërimit të tij nga ERE, si dhe nenin 9 të Direktivës 2009/72/EC, dhe çdo akt tjetër ligjor në aspekt të këtij detyrimi.

Duke konsideruar raportin vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të OST sh.a. për vitin 2024, si një dokument zyrtar që synon të informojë rregullatorin mbi masat e marra për zbatimin e detyrimeve të Programit të Pajtueshmërisë dhe për sigurimin e një veprimtarie të pavarur, transparente dhe jodiskriminuese të operatorit në treg; Duke vlerësuar se raporti për vitin 2024 është hartuar dhe dorëzuar në përputhje me afatet dhe standardet e përcaktuara në program, është i strukturuar sipas metodologjisë së kontrollit të miratuar dhe reflekton zbatimin e shumicës së rekomandimeve të mëparshme të ERE-s.

VLERËSON

Në vijim të shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2024, në zbatim të programit të pajtueshmërisë, Bordi i ERE-s konstaton:

1. OST sh.a. ka përmbushur pjesërisht detyrimet thelbësore që rrjedhin nga Programi i Pajtueshmërisë, Ligji nr. 43/2015 dhe aktet rregullatore në fuqi.

2. Veprimtaria e OST sh.a. gjatë vitit raportues është zhvilluar përgjithësisht në përputhje me parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe ndarjes funksionale.
3. Përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe institucionale për dorëzimin e raportit në gjuhën shqipe dhe angleze.
4. Zbatimin e një metodologjie, të strukturuar kontrolli për mbledhjen dhe analizimin e informacionit, përfshirë monitorimin e proceseve vendimmarrëse të operatorit, kontratave, ankesave dhe të dhënave të raportuara nga strukturat e brendshme.
5. Statusi ligjor i shoqërisë; Në përputhje me Programin, dhe detyrimet ligjore është garantuar ndarjadhe Pavarësia e OST sh.a. Shoqëria ka si aksionar të vetëm shtetin, sipas VKM nr. 317/2016, çka siguron pavarësi operative dhe institucionale nga operatorët e tjerë të sektorit energjetik në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.
6. Struktura organizative e OST; Struktura organizative është konceptuar në mënyrë të tillë që të mbështesë ndarjen funksionale të përgjegjësi, të sigurojë pavarësinë operative dhe të mundësojë përmbushjen efektive të detyrimeve ligjore dhe rregullatore të shoqërisë. Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe i Administratorit është realizuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 317/2016 dhe Statutit të OST. Vendimet përkatëse të Asamblesë së Përgjithshme që lidhen me emërimet dhe riemërimet janë publikuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, duke garantuar transparencë dhe respektim të kërkesave ligjore.
7. Ndarja dhe Pavarësia e Ost; Pavarësia institucionale e OST gjatë vitit 2024 është garantuar në përputhje me kërkesat e nenit 54 dhe 58 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike. Gjithashtu Shoqëria demonstroi pavarësi të plotë financiare dhe respekton standardet e raportimit dhe transparencës të kërkuara nga ERE dhe Traktati i Komunitetit të Energjisë si dhe ka respektuar pavarësinë operacionale duke përmbushur detyrimet që burojnë nga rregullorja e ERE-s nr. 106, datë 02.07.2020 dhe marrëveshjet me SEE CAO e ENTSO-E. OST sh.a. ka përmbushur detyrimet ligjore dhe rregullatore për pavarësinë funksionale dhe vendimmarrëse. Detyrimi për pavarësinë e audituesit financiar është përmbushur plotësisht. Zyrtari ka vlerësuar se OST ka respektuar parimet e vendosjes së pagave dhe ndalesës së punësimit/transferimit, duke garantuar pavarësinë e drejtuesve.
8. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese; OST sh.a. ka zbatuar parimet e përjashtimit të sjelljes diskriminuese dhe menaxhimit të konfliktit të interesit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe Programin e Pajtueshmërisë. Kontratat dhe dokumentacioni përkatës janë administruar dhe arkivuar rregullisht dhe kanë qenë të disponueshme për verifikim. Gjatë periudhës raportuese nuk janë paraqitur ankesa, raporte apo raste të evidentuara lidhur me konfliktin e interesit nga drejtuesit, punonjësit apo palët e treta, çka dëshmon funksionimin e mekanizmave parandalues dhe të kontrollit të brendshëm të shoqërisë.

9. Siguria dhe Sistemet e Informacionit; Gjatë vitit 2024, OST ka garantuar sigurinë e informacionit përmes sistemeve të sigurta dhe të kontrolluara për përpunimin e të dhënave teknike dhe tregtare, në përputhje me standardet e ENTSO-E dhe Programin e Pajtueshmërisë. Masat e sigurisë kibernetike janë zbatuar në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe standardet e BE-së, ndërsa menaxhimi i riskut është realizuar në mënyrë proaktive dhe të dokumentuar. Kontrolli mbi të dhënat sensitive dhe transparenca kanë qenë efektive. Gjatë vitit 2024 nuk janë raportuar incidente të sigurisë kibernetike.
10. Informacioni publik; Gjatë vitit 2024, OST sh.a. ka respektuar pjesërisht kërkesat e Programit të Pajtueshmërisë lidhur me informacionin publik. Informacioni me karakter publik, i cili nuk klasifikohet si konfidencial apo tregtarisht i ndjeshëm, është vënë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të treta, në përputhje me legjislacionin në fuqi. OST ka publikuar në faqen zyrtare informacionin e kërkuar mbi shërbimet e ofruara, kushtet teknike për akses dhe lidhje me sistemin e transmetimit, si dhe të dhëna mbi kapacitetet e sistemit dhe vëllimet e energjisë së transmetuar.
11. Monitorimi i zbatimit të Programit - Zyrtari i Pajtueshmërisë ka realizuar shumicën e detyrave të përcaktuara në Programin e Pajtueshmërisë, duke përfshirë monitorimin e zbatimit të Programit, raportimin vjetor, dhënien e rekomandimeve brenda OST, hetimin e shkeljeve të pretenduara, menaxhimin e konflikteve të interesit, koordinimin me ERE dhe autoritetet e tjera, si dhe dhënien e opinionëve mbi përputhshmërinë e dokumenteve dhe veprimeve të OST. Sha.

REKOMANDON

1. Zyrtari i Pajtueshmërisë të raportojë në mënyrë të plotë, të qartë dhe të strukturuar mbi strukturën aktuale organizative, funksionale dhe teknike të OST sh.a., duke pasqyruar ndarjen e funksioneve, linjat e varësisë dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe çdo ndryshim të kryer gjatë vitit raportues 2024 ose konstatimin e mungesës së ndryshimeve. Raportimi duhet të përfshijë gjithashtu vendimmarrjet përkatëse për miratimin apo ndryshimin e strukturës organizative, si dhe planifikimin e ndryshimeve të mundshme në përputhje me nevojat operacionale të shoqërisë.

Ky raportim duhet të realizohet në përputhje me përcaktimet e Programit të Pajtueshmërisë, përfshirë dispozitat përkatëse mbi statusin ligjor dhe strukturën e shoqërisë, si dhe me strukturën organizative të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, me qëllim garantimin e vazhdueshëm të pavarësisë funksionale, menaxheriale dhe vendimmarrëse të operatorit. Raportimi rekomandohet të kryhet brenda dy muajve të parë të vitit pasardhës.

3. Informacioni publik; Konstatohet se gjatë vitit 2024 nuk është publikuar metodologjia për përcaktimin e tarifës, siç parashikohet në pikën 43.2, gërma “C” të Programit të Pajtueshmërisë. Rekomandohet që OST sh.a. të publikojë metodologjitë përkatëse në faqen zyrtare, në përputhje me kërkesat e Programit të Pajtueshmërisë. Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet

të monitorojë dhe të raportojë pranë ERE-s përmbushjen e këtij detyrimi, brenda afateve të përcaktuara.

4. Monitorimi i zbatimit të programit; Rekomandohet forcimi i monitorimit të trajnimeve dhe udhëzimeve, përfshirë zhvillimin e trajnimeve të detajuara për stafin e ri përpara fillimit të detyrës, si dhe vendosja e një mekanizmi të qartë dhe të dokumentuar për raportimin dhe ndjekjen e shkeljeve të Programit të Pajtushmërisë. Gjithashtu, rekomandohet sigurimi i përmbushjes së plotë të detyrimeve lidhur me informacionin publik, përfshirë publikimin e të dhënave të kërkuara nga Programi, veçanërisht metodologjitë për përcaktimin e tarifave të transmetimit dhe të tarifës së lidhjes, si dhe përfshirja e një dokumentimi sistematik të udhëzimeve dhe konsultimeve të dhëna për stafin e OST sh.a. Rritja e transparencës në raportimin mbi investimet dhe propozimet e planit 10-vjeçar për rrjetin e transmetimit duke marrë pjesë në takimet e strukturave përcaktuar kjo edhe në programin e pajtushmërisë
5. Rekomandohet që OST sh.a. dhe Zyrtari i Pajtushmërisë të marrin masat e nevojshme për përmbushjen e plotë të rekomandimeve të dhëna nga ERE për vitin 2023, duke siguruar raportim të detajuar mbi veprimet e ndërmarra dhe nivelin e zbatimit të tyre, në përputhje me Programin e Pajtushmërisë dhe kuadrin rregullator në fuqi.
 - Zyrtari i Pajtushmërisë të depozitojë pranë ERE-së informacion të detajuar mbi përdorimin e të ardhurave nga rrjeti OPGW, duke përfshirë analizën e kryer nga Drejtoria Teknike dhe vlerësimin e tij të pavarur, me qëllim garantimin e transparencës dhe pavarësisë financiare dhe operacionale të OST sh.a., në përputhje me Programin e Pajtushmërisë dhe Vendimin nr. 194/2019 dhe korrespondencave të realizuara për këtë qëllim gjatë vitit 2024.
 - OST sh.a. të sigurojë njoftimin ndaj Zyrtarit të Pajtushmërisë për mbledhjet e planifikuara, Zyrtari i Pajtushmërisë të sigurojë marrjen pjesë në të gjitha mbledhjet e organeve drejtuese dhe mbikëqyrëse të shoqërisë, përfshirë Këshillin Mbikëqyrës dhe Asamblenë e Përgjithshme, në përputhje me pikat 57 dhe 58 të germës “B” të Programit të Pajtushmërisë. Për këtë qëllim, të përmirësohen mekanizmat e njoftimit dhe komunikimit të brendshëm, duke garantuar aksesin e Zyrtarit në materialet dhe informacionet përkatëse përpara zhvillimit të mbledhjeve.
 - Të përmirësohet niveli i detajimit dhe dokumentimit të rezultateve të monitorimit të ndryshimeve ligjore dhe rregullatore, lidhur me njohjen dhe zbatimin e Programit të Pajtushmërisë.